



Aspektet kyçe të situatës sociale dhe ndërtimi i sistemit të pensioneve

Raport hulumtues

Përgatitur nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest në kuadër të projektit “Promovimi i Zhvillimit Ekonomik nëpërmjet Shoqërisë Civile”, në bashkëpunim me Qendrën për Ndërmarrjet Ndërkombëtare Private (CIPE) nga Washingtoni dhe i mbështetur nga USAID-i

**Prishtinë,
Dhjetor, 2001**

REZYME

1. Ndërtimi i skemës së re të pensioneve, përkatësisht të sistemit të pensioneve në Kosovë, në kontekstin e gjendjes së përgjithshme sociale, papunësisë dhe varfërisë paraqet njërin nga çështjet më urgjente sociale dhe ekonomike në Kosovë.
2. UNMIK-u, AQF dhe akterë të tjerë të rëndësishëm, siç janë Banka Botërore, USAID-i dhe ILO kanë zhvilluar një aktivitet intensiv për ndërtimin e skemës së re të pensioneve në Kosovë. Si rezultat të kësaj, Propozimi i Rregullores mbi pensionet është paraqitur dhe pret për aprovim.
3. Nga analiza e zgjidhjeve të propozuara në sistemin e ri të pensioneve në Kosovë dhe nga përvojat e vendeve të zhvilluara dhe të vendeve në tranzicion del se skema e pensioneve, e propozuar në Kosovë, ka shfrytëzuar përvojat e sistemeve më të avansuara, duke i vënë në kontekstin specifik kosovar.
4. Skema përfshinë gjithë popullatën e Kosovës të moshës mbi 65 vjeçare, të cilëve u sigurohet pensioni elementar që u ndihmon të moshuarve të përballojnë konsumin bazik dhe kontribuon në të ardhurat e familjeve të tyre. Gjithashtu, inauguron për herë të parë, kontributin e punëtorëve dhe punëdhënësve në një skemë moderne, me zgjidhje të qëndrueshme për investimin e fondeve të pensioneve dhe me një rrezik sa më të vogël.
5. Duke promovuar edhe mundësinë e sigurimit të kornizës ligjore për planet plotësuese të kontributit vullnetar, kjo skemë gjithsesi do të jetë një moment i ri edhe për ngritjen e kulturës së kursimit në popullatën e Kosovës. Krijimi i fondeve të pensioneve dhe mundësitë e investimit të tyre në tregun e kapitalit gjithsesi paraqet një moment të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Besojmë se kjo skemë do të nxitë edhe krijimin sa më të shpejtë të tregut të kapitalit në Kosovë.
6. Normat e propozuara të kontributeve janë më të ulëta në krahasim me shumë vende të tjera. Mund të pritët që këto norma do të akceptohen mirë nga punëtorët dhe nga punëdhënësit. Niveli i kontributeve, sipas shtyllës së paraparë në Kosovë, është i krahasueshëm me ato në Zvicër (9,8%), në Kanadë (6%) dhe në SHBA (12%), kurse janë për dy deri në katër herë më të ulëta se sa niveli në shtetet në tranzicion (Shqipëria 36%, Bullgaria 32%, Sllovenia 24%) . Duke u nisur nga kjo do të jetë shumë me rëndësi që opinionit kosovar t'i bëhen me dije të gjitha këto zgjidhje që i ofron skema e propozuar e pensioneve me qëllim që të sigurohet një përkrahje dhe angazhim për implementimin e saj sa më të shpejtë.

7. Gjatë procesit të ndërtimit të sistemit të pensioneve në Kosovë duhet të angazhohen resurse substanciale dhe të zhvillohen kapacitete administrative, për t'i menaxhuar në mënyrë efikase pagesat e pensioneve bazike: duhet të rekrutohet dhe trajnohet personeli i ri, duhet të renovohen objektet dhe duhet të bëhen aranzhmanet për shpërndarjen e pensioneve.
8. Struktura e shtyllës së propozuar në rregullore do të mundësojë zvogëlimin e shpenzimeve administrative në sistemin e ri. Duhet të zhvillohen politikat të cilat e kufizojnë rritjen e këtyre shpenzimeve, por që ende sigurojnë shërbime adekuate.
9. Gjatë tërë procesit të ndërtimit të sistemit të pensioneve në Kosovë do të ndeshemi me probleme të natyrave të ndryshme, disa prej të cilave kërkojnë zgjidhje të menjëhershme, ndërsa të tjerat duhet të jenë pjesë e strategjisë afatgjate të reformës. Aktualisht janë një spektër çështjes të hapura, të cilat kërkojnë zgjidhje, kurse nuk kanë arritur të gjejnë vend të merituar në Draftin e tanishëm të pensioneve, por do të adresohen më vonë. Ne besojmë se definimi i një strategjie më të gjërë për reformimin e sektorit social në afat të gjatë kërkon që të merren parasysh aspektet, si vijojnë:
 - a) Pozita sociale e punëtorëve, të cilat janë përjashtuar nga puna, menjëherë pas okupimit të Kosovës nga Serbia në vitin 1990, të cilët nuk i plotësojnë kushtet për pensionin e pleqërisë, kurse tani për shkak të moshës së shtyrë nuk mund të gjejnë punë në ndërmarrjet e tjera. Këto punëtorë aktualisht janë të privuar nga dy të drejta, nga e drejta në pagë dhe nga e drejta në pension (deri sa të mbushin 65 vjeç);
 - b) Pozita e sociale e pensionistëve aktualë vështirë se mund të zgjidhet me pensionin bazë, i cila nuk do t'i plotësonte as nevojat elementare, e të mos flasim për shportën jetësore, të vlerësuar nga Banka Botërore.
 - c) Një ndër çështjet më aktue, është ajo e zgjidhjes së statusit të pensionistëve dhe invalidëve të punës dhe të luftës. Duhet të përcaktohen kriteret dhe të zhvillohen kapacitetet për vlerësimin efikas të rasteve që i përkasin invaliditetit. Me rëndësi është që të vërtetohet statusi invalidor i çdo pensionisti dhe me ligj të veçantë të rregullohet pensioni invalidor.
 - d) Çdo propozim që i përket zhvillimit të sektorit social në Kosovë duhet të analizohet nga perspektiva e implikimeve potenciale makroekonomike dhe buxhetore. Analizat tona mbi tregun vendor të punës tregojnë se programet sociale të financimit ekstenziv nga kontributet në paga mund të hasin në vështirësi duke e pasur

parasysh nivelin e ultë të punësimit formal. Gjatë periudhës së keqësimit të gjendjes sociale, procesi i marrjes së vendimeve duhet të jetë i balancuar në mënyrë të ndjeshme ndërmjet nevojave për asistencë sociale dhe prioriteteve zhvillimore;

- e) E drejta e pensionit bazë parashihet për të gjithë qytetarët e Kosovës, të cilët mbushin moshën 65 vjeçare. Edhe pse kjo nënkupton barazinë e plotë të tyre shoqërore, ata nuk do të jenë të pabarabart materialisht, sepse një numër i tyre marrin edhe pensione të tjera, si nga Beogradi ashtu edhe nga shtetet e tjera perëndimore, çështje kjo e cila meriton shqyrtim të veçantë;
- f) Objektivisht në situatën konkrete, adresimi i këtyre problemeve do të orientohet kah buxheti i Kosovës, i cili pas uljes së nivelit të dotacioneve, do të përballojë edhe shumë probleme të mëdha (veçanërisht pagat në sektorin publik dhe nevojat për investime kapitale në veprimtaritë publike, si në arsim, kulturë etj.). Disa nga këto relacione do të pasqyrohen në kapitullin vijues. Në këtë situatë e veçanërisht për zgjidhjen e problemeve të pensionistëve aktualë të moshës dhe atyre invalidorë dhe të punëtorëve të përjashtuar nga puna, të cilët akoma nuk i plotësojnë kushtet për pension, përkatësisht për zbutjen e problemeve sociale, zgjidhja e mundshme racionale do të jetë shfrytëzimi i pjesshëm i fondeve nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore. Vëmendje e posaçme politike duhet t'i kushtohet shfrytëzimit potencial të mjeteve nga privatizimi për pensionistët të cilët kanë kontribuar në sistemin e vjetër. Së këndejmi, nxitja e fillimit të procesit të privatizimit edhe në këtë aspekt paraqitet si nevojë e domosdoshme.

REKOMANDIME

- (1) Rekomandohet aprovimi sa më i shpejtë i skemës së re pensionale dhe vënia e saj në veprim që nga fillimi i vitit të ardhshëm.
- (2) Përmirësimi i gjendjes së pensionistëve ekzistues duhet të merret parasysh edhe më tutje me rastin e formulimit të strategjisë afatgjate për zhvillimin social të Kosovës. Çështja e invalidëve të punës dhe të luftës duhet të merret parasysh sa më shpejt që është e mundur. Ndërkohë, është e rëndësishme që të rishqyrtohen kriteret sociale, me qëllim që të përfshihen këto kategori, derisa të rregullohet pozita e tyre me ligj.
- (3) Organet e Kosovës, të cilat e përcaktojnë nivelin e pensioneve bazë, nevojitet të marrin në shqyrtin nevojën që niveli i pensionit bazë edhe në periudhën fillestare të sigurojë minimumin ekzistencial të pensionistëve.
- (4) Është e nevojshme të merret parasysh shfrytëzimi i një pjese të aksioneve nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore si kompenzim për pensionistët të cilët kanë dhënë kontributet e tyre në sistemin e kaluar të pensioneve, ashtu siç është vepruar në disa vende.
- (5) Është e nevojshme vënia në veprim e një programi gjithpërfshirës të asistencës teknike për ndërtimin e kapaciteteve manaxheriale dhe administrative të administratës për të dy shtyllat e propozuara.
- (6) Është i nevojshëm zbatimi i një programi të njoftimit dhe edukimit të opinionit mbi zgjidhjet e skemës së re të pensioneve në kontekstin e përgjithshëm ekonomik dhe social të Kosovës.

ASPEKTET KYÇE TË GJENDJES SOCIALE DHE NDËRTIMI I SISTEMIT TË PENSIONEVE

1. HYRJE

Hartimi i këtij raporti dhe diskutimi i tij në Tryezën e Forumit Ndërkombëtar është një modul në kuadër të Projektit dyvjeçar me titull “Promovimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet shoqërisë civile”, të cilin Instituti Riinvest po e realizon në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare të Ndërmarrjeve Private (CIPE) në Washington, mbështetur nga USAID-i në Prishtinë. Projekti ka për qëllim që:

1. të përmirësojë politikat ekonomike dhe rrethinën e biznesit në Kosovë, nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së faktorit lokal në hartimin dhe në debatimin e politikave ekonomike
2. të grumbullojë dhe të analizojë informatat lidhur me efektivitetin e politikave të zhvillimit ekonomik;
3. të iniciojë debatet lidhur me këto politika dhe
4. të inkuadrojë komunitetin e biznesit dhe të shoqërisë civile në dialogun për çështjet vitale të reformave ekonomike, përkatësisht në ndërtimin e ekonomisë së hapur të tregut.

Gjatë vitit të parë të implementimit të këtij projekti janë zhvilluar tri module të tij dhe janë diskutuar në Tryezën e Forumit Ndërkombëtar tri tematika: privatizimi; disa çështje të ndërtimit dhe të zbatimit të politikës fiskale dhe financimit dhe zhvillimi i NVM-ve. Lidhur me këto çështje janë prezantuar rekomandimet që kanë reflektuar rezultatet e kërkimeve të Riinvest, qëndrimet e qarqeve profesionale dhe të komunitetit të biznesit në Kosovë.

Ky është Raporti i katërt studimor, në të cilin trajtohen “Disa çështje aktuale të gjendjes sociale dhe sistemi pensional në Kosovë”. Raporti i referohet aktualitetit të ndërtimit të sistemit të pensioneve në Kosovë, në kontekstin e gjendjes së përgjithshme sociale, me theks në gjendjen e pensionistëve aktualë dhe të nevojave për ndërtimin e një sistemi bashkëkohor të pensioneve, në harmoni me proceset aktuale zhvillimore, me modelimin e sistemit të ekonomisë së hapur të tregut dhe me specifikat e Kosovës.

1.1. Qëllimi i raportit hulumtues

Qëllimi i këtij raporti është rekomandimi dhe advokimi i ndërtimit të sistemit të pensioneve në Kosovë, si një segment i rëndësishëm i sigurimeve shoqërore dhe nënsistem i rëndësishëm i buxhetit të Kosovës, në ndërlidhje të ngushtë me institucionet financiare.

- Raporti ka për qëllim të prezantojë gjendjen momentale sociale në Kosovë, që ndërlidhet me gjendjen e pensionistëve, duke u nisur nga problemet e gjertanishme të funksionimit të sistemit pensional në Kosovë si dhe nga përvojat e ndërtimit dhe të reformimit të skemave pensionale në vendet e tjera.

Raporti adreson çështjet specifike si vijojnë:

- a. Problemet aktuale të pensionistëve dhe të ndërtimit të sistemit pensional në Kosovë:
 - gjendja sociale dhe pozita aktuale e pensionistëve;
 - nevojat urgjente të ndërtimit të sistemit të ri të pensioneve;
 - aktiviteti i deritanishëm në ndërtimin e sistemit të pensioneve;
 - zgjidhjet e ofruara në konceptin e sistemit të ri të pensioneve;
 - përvojat nga sistemet pensionale të vendeve të Unionit European, OECD-së dhe të vendeve në tranzicion;
- b. Problemet e hapura lidhur me sistemin e ri pensional, që kanë të bëjnë me:
 - pozitën aktuale ekonomike të pensionistëve;
 - pozitën specifike të pensionistëve invalidorë;
 - kapacitetet manaxheriale të administrimit të pensioneve.
- c. Zgjedhjet e sistemit të pensioneve në kontekstin e reformave ekonomike dhe zhvillimit ekonomik të lidhura me:
 - relacionet e pensioneve me shtimin e GDP-isë
 - relacioneve në mes pensioneve, pagave, punësimit dhe konsumin buxhetor dhe
 - kapitalizimin e kontributeve për pensione, si të atyre mandatare ashtu edhe të kontributeve vullnetare, nëpërmjet interaksionit me institucionet financiare.

Në përgatitjen e këtij Raporti studiuës, përveç aktiviteteve hulumtuese të stafit të Riinvestit dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm, janë shfrytëzuar edhe rezultatet e projekteve të këtij Instituti, të realizuara deri tash, si:

- “Aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi demokratik i Kosovës”;
- “Ndërtimi dhe funksionimi i institucioneve të pushtetit lokal në Kosovë”;
- “Rindërtimi i Kosovës pas luftës- strategjia dhe politikat”;
- Anketa në 300 ndërmarrje private 1997, 1999 dhe 2000;
- Anketa në 194 ndërmarrje shoqërore, në vitin 2000 dhe

1.2. Metodologjia

- Anketa në 3500 familje dhe ekonomi familjare.

Në përgaditjen e këtij raporti janë shfrytëzuar edhe materialet e:

- Bankës Botërore
- Organizatës Ndërkombëtare të Punës
- Organeve të UNMIK-ut
- Institutit të Statistikës
- Literatura dhe interneti si dhe
- Përvojat nga Sllovenia, Shqipëria Hungaria, IRJ e Maqedonisë, Kroacia, Polonia, Kazakistani dhe të disa vendeve të OECD dhe të vendeve të zhvilluara.

Në kuadër të përgatitjes së këtij studimi, janë zhvilluar edhe këto aktivitete:

- Me qëllim të përkufizimit të kornizave të studimit dhe të harmonizimit të aktiviteteve, janë mbajtur disa takime me ekipin e përpunimit të sistemit të ri të pensioneve , në AQF, dhe në USAID;
- Janë zhvilluar 5 intervista me pensionistë të strukturave të ndryshme sociale;
- Si aktivitet të veçantë hulumtues RIINVESTI ka zhvilluar një anketë me 110 pensionistë. Mostra e anketës ka qenë e rastit. Ajo ka përfshirë 7 regjionet kryesore të Kosovës dhe nga secili regjion janë përfshirë mesatarisht nga 15 pensionistë: nga 5 pensionistë nga fshati dhe nga 10 nga qyteti. Në mostër gjithashtu janë përfshirë 4 kategori të pensionistëve, si më poshtë;
 - Pensionistë të pleqërisë
 - Pensionistë me pensione të beneficuara
 - Pensionistë invalidorë të punës dhe
 - Pensionistë familjarë.
- Lidhur me shfrytëzimin e përvojave të vendeve në tranzicion Riinvesti ka realizuar një udhëtim studiues në Shqipëri dhe një në Slloveni, ku janë studiuar përvojat e këtyre vendeve në fushën e politikës sociale dhe të pensioneve. Gjithashtu kemi marrë tri kontribute personale të ekspertëve nga vendet në tranzicion (Sllovenia, IRJM, Polonia), të cilat jepen në aneks të këtij raporti.
- Gjatë hartimit të këtij Raporti janë shfrytëzuar mendimet e ekspertëve të pavarur të vendit dhe të atyre ndërkombëtarë.

- Në anks të Raportit janë prezantuar shkurtimisht dhe përvojat nga Hungaria, Kroacia, Shqipëria, Kili ,Bolivia, Latvia dhe Kroacia.
- Raporti studimor është shqyrtuar në Bordin Këshilldhënës të Riinvestit dhe me një grup afaristësh.

Problemet sociale të Kosovës janë si pasojë e problemeve zhvillimore që kanë përcjellur Kosovën në të kaluarën dhe e politikave diskriminuuese, të udhëhequra nga pushteti serb. Krahas gjithë kësaj lufta në Kosovë solli për pasojë zhvendosjen e rreth 90% të popullsisë nga shtëpitë e tyre, nga të cilët 64% janë deportuar me dhunë jashtë Kosovës. Dëmet e drejtpërdrejta në sektorin privat të ekonomisë, si në ekonominë familjare, plaçkitjet e parave të gatshme, rrënimimi ose djegja e 40% të shtëpive të banimit, pajisjeve shtëpiake, humbjet në të mbjella, pajisje bujqësore në fonde të bagëtisë, dëmet në zeytari, në ndërmarrje private etj., kanë shkaktuar zvogëlimin e të hyrave buxhetore të familjeve për rreth 70%. Pas luftës, për shkak të rrethanave të krijuara, 8% e familjeve të shpërngulura apo dëportuara nuk janë kthyer në vendbanimet e mëparshme (boxi 1).

2.DISA ASPEKTE TË GJENDJES SOCIALE NË KOSOVË

Boxi 1: Studimet mbi vlerësimin e varfërisë në Kosovë

Në Kosovë, deri më tani, janë dy studime kryesore mbi varfërinë. Këto studime i qasen varfërisë nga kënde të ndryshme. Anketa e LSMS (Studimi i përlogaritjes së standardit të jetesës) përcakton varfërinë në bazë të shpenzimit, kurse studimi i CARE ka një qasje multidimensionale, pra konceptin e sigurisë së mjeteve të jetesës së familjeve. E para e definon varfërinë ekstreme të jetës „nën vijën e varfërisë ushqimore“ në një familje me resurse të pamjaftueshme për të siguruar shportën themelore ushqimore, që do të siguronte sasinë ditore prej 2100 kalorishë për të rritur. Kjo në Kosovë do të korespondonte me shpenzimin ditor prej 0.8 US\$ (1,8539 DM) për të rritur. Vija e plotë e varfërisë është definuar si një shpenzim më i gjërë i përbërë edhe prej artikujve joushqimorë, deri në shumën prej 1.5 US\$ (3,499 DM) për të rritur

Studimi i CARE varfërinë e paraqet në aspektin e mungesës së disa cilësive fizike dhe prodhuese si dhe atyre jomateriale, shoqërore dhe njerëzore. Vlerësohet se shkaqët e varfërisë në Kosovë vijnë nga rënia ekonomike në vitet e nëntëdhjeta, që u thellua më vonë me humbje të punës, me mundësi të kufizuara për biznes, dëme gjatë luftës, pasuri të humbura dhe shkatërrim të infrastrukturës rurale.

(Nxjerrë nga Vlerësimet e Bankës Botërore, ILO dhe UNMIK)

Gjysma e popullsisë së Kosovës gjendet në nivel të varfërisë, kurse 12% nga kjo pjesë e popullatës jetojnë nën nivelin e varfërisë ekstreme¹. Kjo do të thotë se në Kosovë jetojnë në kushte të varfërisë 1 milion deri 1,200 mijë banorë².

¹ Vlerësime të Bankës Botërore në Tryezën në temën “ Kosova, vlerësimi i varfërisë”, mbajtur në Prishtinë më 11 tetor 2001, dhe të ILO & UNMIK: NË DREJTIM TË STRATEGJISË SË SIGURIMIT SOCIAL NË KOSOVË, Prishtinë, 25 shtator 2001.

² Së bashku me komponentën migruese

Këta banorë ushqehen dobët, vishen shumë keq, jetojnë në ambient shumë të papërshtatshëm, nuk kanë kushte higjienike, nuk kanë mundësi për shkollim dhe shërbime shëndetësore.

Ndër problemet shumë të rënda sociale, të cilat meritojnë kujdes dhe zgjidhje sa më të shpejtë vlerësojmë se janë:

- *Gjendja e pensionistëve ekzistues, të cilët nuk marrin pensione që nga viti 1999;*
- *Gjendja e invalidëve të luftës, të cilët janë të moshës së re dhe të paafte për punë;*
- *Gjendja e pensionistëve invalidorë, të cilët për shkak të moshës nuk do t'i plotësojnë kushtet për pensionin bazë;*
- *Fëmijët pa dy prindër;*
- *Popullata në gjendje të varfërisë së skajshme, rreth 12% e saj;*
- *Familjet e mbetura pa kryefamiljar, kryesisht familje vetëm me gra, të cilat nuk kanë ndonjë përgatitje shkollore apo profesionale për t'u futur në aktivitetet ekonomike;*
- *Pjesa e popullatës rurale, e cila përkohësisht është e vendosur në qytet, kurse nuk ka burime ekonomike të jetesës, përveç atyre të përkohshme nga organizatat humanitare etj.*

2.1 Mirëqenia sociale

Nga pasojat e luftës mbetën shumë familje pa kujdestarë të familjes, mbi 1200 fëmijë mbetën pa dy prindër, u keqësua gjendja materiale e invalidëve të luftës.

Programit të mirëqenies sociale, vetëm në vitin 2001 iu nënshtruan mbi 53.916 familje,³ me gjithsej 186.308 anëtarë. Niveli i ndihmave materiale shtrihet ndërmjet shumës 60 dhe 120 DM për një familje. Situata të rëndë ekonomike po përjetojnë edhe ish punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore, të cilët kanë mbetur pa punë dhe pa burime të rregullta për ekzistencë. Derisa në vitin 1990, 1.7% e popullsisë shfrytëzonte asistencë sociale, në vitin 2001 këtë e bënin 9.3% e popullsisë. Mirëpo, shifet se sistemi i asistencës sociale nuk e përfshinë numrin e përgjithshëm të popullsisë, që jetojnë në kushtet e varfërisë ekstreme.

2.2. Të ardhurat familjare

Keqësimi i gjendjes sociale në Kosovë manifestohet në zvogëlimin e burimit të të hyrave buxhetore të familjeve për 50%. Të ardhurat (buxheti familjar) kanë rënë në një mesatare prej 300 DM në muaj. Në krijimin e kësaj gjendjeje ka ndikuar, pos tjerash, edhe mungesa e sistemit të pensioneve dhe zvogëlimi i dërgesave nga jashtë.

Në krahasim me periudhën e parakonfliktit është zvogëluar numri i familjeve që marrin paga, numri i familjeve me të ardhura nga biznesi dhe burime tjera të të

³ Burimi: Instituti për Politikë Sociale

hyrave. Në anën tjetër, është dhjetëfishuar numri i familjeve që jetojnë nga ndihmat humanitare dhe është dyfishuar numri i familjeve që jetojnë vetëm nga dërgesat nga bota e jashtme. Dërgesat nga bota e jashtme dhe të ardhurat nga veprimtaria dhe pagat ishin gjysma e burimit të mjeteve buxhetore të familjes kosovare menjëherë pas luftës. Në periudhën e pasluftës është karakteristike mospërputhja e të hyrave buxhetore me konsumin buxhetor të familjes. Shumë familje detyrohen të konsumojnë edhe mjetet e kursyera apo kapitalin e patundshëm, me qëllim të mbijetesës. Në shpenzimet familjare, vetëm shpenzimet e ushqimit apsorbojnë afër 60% të buxhetit të familjes.

Familjet fshatare kanë të hyra të ulëta dhe vështirë të kuantifikueshme. Një kategori e familjes rurale, që iu shkatërrua baza ekonomike dhe burimet e jetës gjatë luftës, gjeti strehim në qytet. Kjo kategori e popullsisë paraqet strukturë specifike sociale. Kryesisht është e papërgatitur për jetë urbane, pa arsimim dhe kualifikim profesional, që do t'i mundësonte ndonjë aktivitet ekonomik për ekzistencë.

Kategoria e popullsisë urbane, edhe pse përbën vetëm 40% të popullsisë së gjithmbarshme, përbën një pjesë të madhe të popullsisë së varfër dhe me varfëri të thellë. Për disa familje urbane mungesa e vendit të punës është mungesë e burimit të mjeteve për ekzistencë. Element tjetër që ka ndikuar në rritjen e numrit të të varfërve të skajshëm në qytet është shpërngulja e një pjese të madhe të popullsisë rurale nga fshati në qytet (rreth 12%), të cilëve në vendbanimin e mëparshëm iu është shkatërruar baza ekonomike dhe kanë gjetë strehim në qytet (atje ku edhe ndihmat humanitare janë më afër).

Niveli i lartë i papunësisë, si pasojë e problemeve zhvillimore në të kaluarën, nga rrethanat e luftës dhe mangësitë e manaxhimit në fazën e emergjencës, paraqitet si problem qenësor social dhe ekonomik në Kosovë. Rreth 10% ose më shumë familje kosovare nuk kanë asnjë anëtar të familjes të punësuar. Shkalla e papunësisë nga burimet e ndryshme vlerësohet të sillet në intervalin prej 45% deri në 55%, ndërsa menjëherë pas luftës vlerësohej të ishte 74%.

2.3.Varfëria në viset rurale dhe urbane

2.4.Papunësia dhe punësimi

Tabela 1: Struktura e fuqisë punëtore në Kosovë

Llojet e punësimit	Nr. i të punësuarve (në njëmijë)	Struktura %
Ndërmarrjet private	135	30
Bizneset tjera	50	11
Ndërmarrjet shoqërore	50	11
Shërbimet publike	75	17
Fermerët	90	20
Bizneset e vogla të përgjithshme	50	11
Numri i përgjithshëm i të zënëve me punë në Kosovë	450	100%
Punësimi në botën e jashtme	100-150	23.8

Burimi: Vlerësimet e Institutit "Riinvest" në bazë të anketave

Në mungesë të burimeve të sakta statistikore, vlerësimet lidhur me punësimin dhe papunësinë ndryshojnë varësisht nga burimet,⁴ mirëpo ato janë të përafërta sa i përket gjendjes së përgjithshme. Në mungesë të rregullativës juridike dhe të institucioneve të mbikqyrjes, punësimi të shumtën e rasteve është bërë jashtë institucioneve të punësimit, duke mos i respektuar normat juridike, kështu që organet kompetente nuk kanë pasqyrë të sakt mbi numrin e të punësuarve. Edhe pse me vlerësime të përafërta, prapëseprapë është e qartë se niveli i punësimit është jashtëzakonisht i ultë, gjë që paraqet sfidë të madhe për zhvillimin makroekonomik dhe social të Kosovës. Krijimi i një rrethine e cila do të mundësonte gjenerimin e vendeve të punës, duhet të jetë politikë prioritare. Në të njëjtën mënyrë, politika e zhvillimit duhet të dizajnohet me synimin për investime si në infrastrukturë dhe kapitalin njerëzor, ashtu edhe në mbajtjen e fuqisë punëtore të Kosovës sipas kostos së konkurrencës ndërkombëtare. Çdo propozim i cili lidhet me zhvillimin e sektorit social dhe bazohet në supozimet e financimit të programeve përmes tatimit në paga, duhet të marrë parasysh pasojat për tregun vendor të fuqisë punëtore.

⁴ Nga të dhënat e Departamentit për Punë dhe Politikë Sociale del se kontigjenti aktiv i punës është 35.5%, përkatësisht 469 000 si në vijim - 127 000 në sektorin privat, 108 000 në sektorin publik, 118 000 në sektorin shoqëror (i cili punon me kapacitet shumë të ulët- 20- 30%) dhe 116 000 të angazhuar në bujqësi. Në këtë kontigjent nuk është përfshirë edhe kontigjenti aktiv i punës në botën e jashtme, i cili sipas vlerësimeve të këtij departamenti është prej 300.000-400.000. Në bazë të të dhënave të Fondit për Sigurime Shoqërore vlerësohet se në Kosovë tani janë të punësuar rreth 284.813 punëtorë.

Sistemi pensional hyn në kategorinë e sigurimit social i cili siguron një mbështetje financiare për njerëzit e moshuar dhe për ata të cilët janë të paafitë për punë. Për nga perspektiva individuale, sistemi i pensioneve siguron mekanizmat kryesorë për nivelizimin e konsumit gjatë tërë jetës. Për shumicën e popullatës së moshuar, beneficionet e pensioneve paraqesin burim kryesor të të ardhurave gjatë kohës kur janë në pension. Së këndejmi, çdo vend përcakton një strategji kombëtare që synon ofrimin e sigurimit social për të gjithë, duke shprehur kështu solidaritetin e shoqërisë me grupet në rrezik, për shkak të problemeve shëndetësore, të pleqërisë dhe të papunësisë. Kështu, me mbrojtjen sociale përmes redistribuimit të të ardhurave, sigurohet mirëqenia shoqërore.

3.PROBLEMET AKTUALE TË PENSIONEVE DHE TË NDËRTIMIT TË SISTEMIT PENSIONAL

Aktualisht në Kosovë nuk funksionon sistemi pensional. Pensionistët, të cilët, sipas të dhënave nga fundi i vitit 1998 ishin në numër prej 89.135⁵ vetëve, nuk marrin kurrfarë pensioni, me përjashtim të pensionistëve serb, të cilët vazhdojnë t'i marrin pensionet nga Beogradi dhe të pensionistëve të tjerë të cilët gëzojnë pensione nga shtetet e perëndimit. Pensionistët kanë manifestuar në forma të ndryshme paknaqësinë e tyre me gjendjen në të cilën ndodhen dhe vazhdimisht kërkojnë që të zgjidhet problemi i tyre. Personat e moshuar janë të preokupuar me faktin se ata kanë kontribuar në sistemin e vjetër të pensioneve, por aktualisht nuk janë duke gëzuar ndonjë formë të kompensimit. Me masat represive në Kosovë, ish RFJ pas vitit 1990 ka përjashtuar nga puna rreth 128.000 punëtorë etnikë shqiptarë dhe ua ka pamundësuar atyre të kontribuojnë për pensione. Prandaj, shumica besojnë se obligimet e Beogradit, përpos kompensimeve për kontributet në të kaluarën, lidhen edhe me masat represive dhe të ekzodit të punëtorëve dhe të familjeve të tyre. Ekziston pajtimi se kjo është një çështje politike shumë e rëndësishme dhe se duhet të vëhet në agjendat e ardhshme.

Pas përfundimit të konfliktit në Kosovë, UNMIK-u filloi me programin e asistencës sociale, ku përfshiheshin ndihmat ndaj një kategorie të caktuar të moshuarish. Këto ndihma nuk përfshijnë pjesën më të madhe të popullësisë së moshuar, për më tepër nuk përfshijnë ata që kanë paguar kontribute për pensionet e vjetra. Sistemi i asistencës sociale zbatohet vetëm ndaj familjeve më të vobekëta dhe mbështetet nga asistencë sociale buxhetore dhe jashtëbuxhetore.

Ekziston një nevojë urgjente për zhvillimin e sistemit të ri të pensioneve. Në Kosovë preferohet ndërtimi i sistemit të ri të pensioneve, si pjesë e pandashme e ndërtimit të sistemit të ri ekonomik të Kosovës. Sistemi i ri i pensioneve duhet të bazohet në parimet e drejtësisë dhe barabarësisë, duhet të jetë financiarisht i qëndrueshëm dhe në mënyrë adekuate duhet t'i adresojë interesat e grupeve të ndryshme të popullatës së Kosovës.


⁵ Të dhënat nga Fondi i Sigurimeve Shoqërore, Sektori SPI: Programi orientues për pagesën e pensioneve të pensionistëve kosovarë, Prishtinë, 1.06.2001.

3.1. Zhvillimet demografike në Kosovë

Ekzistojnë vlerësime të ndryshme për numrin aktual të popullsisë në Kosovë. Hulumtimet e Institutit Riinvest⁶ vlerësonin që Kosova në vitin 1997 kishte rreth 2,3 milionë banorë, duke përfshirë edhe kosovarët që përkohësisht janë në botën e jashtme, që do të thotë se në vitin 2001 kishte mbi 2.4 milionë banorë. Vlerësimet e bëra nga institucionet ndërkombëtare e përcaktojnë popullësinë e Kosovës në rreth 2,2 milionë banorë. Nga ky numër mbi 5,7%, ose rreth 130.000 individë janë të moshës 65 vjeç ose më të vjetër. Të moshës së punës (prej 16-64 vjeç) do të jenë rreth 1,5 milion njerëz.

Faktin se edhe popullatën e Kosovës e pret fillimi i një trendi të mplakjes e argumentojnë edhe të dhënat mbi fertilitetin

Figura 1 : Ecuria e fertilitetit në Kosovë




Burimi: Dokumentacioni i Sekretariatit për Zhvillim, Plan dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar Shkencor dhe Teknik të Kosovës (viti 1989).

* Vlerësimet e Institutit "Riinvest".

Një nga faktorët tepër të rëndësishëm që do të ketë ndikuar në zvogëlimin e fertilitetit në vitet e fundit qëndron në migrimin shumë të madh të popullësisë jashtë Kosovës, në periudhën prej vitit 1990 deri në viktin 1999, që ka ndikuar në shtyrjen e martesave dhe në rënien e lindjeve.

Norma demografike e varësisë, përkatësisht raporti i të moshuarve ndaj atyre në moshë të punës është tepër i volitshëm në krahasim me vendet e tjera. Janë mbi 11 njerëz të moshës së punës në Kosovë për çdo të moshuar mbi moshën 65 vjeçare.

⁶ Institut Riinvest: Economic Activities and Democratic Development of Kosova, Prishtinë, September 1998

Figura 2 : Struktura e popullsisë së përgjithshme në Kosovë

Burimi: Të dhënat statistikore

Vlerësime të Institutit Riinvest

Sidoqoftë, norma efektive e varësisë, e definuar si raport ndërmjet të moshuarve dhe atyre të punësuar, është më e lartë. Duke i pasur parasysh të gjithë ata të cilët janë të punësuar, kjo normë sillet prej 1 – 3.5, ose vetëm 1 – 2.4 (ose deri në 2), po qe se përfshihen vetëm ata të cilët mund të jenë pjesë e ekonomisë formale.

Nga të dhënat në grafikun 3 shifet se viteve të fundit ka filluar të bie pjesëmarrja e popullatës së re në popullatën e përgjithshme. Vlerësimet e Riinvestit flasin se që nga viti 1981, për shkak të efekteve të shpërnguljes së të rinjve dhe familjeve të tyre nga Kosova, po vie duke rënë pjesëmarrja e grupmoshës deri në 19 vjeç në strukturën popullatës së përgjithshme, nga 52,3% në vitin 1981 në 48% në vitin 2001. Në të njëjtën kohë kemi rënie të lehtë të pjesëmarrjes të grupmoshës mbi 60 vjeç deri në vitin 1991 dhe rritja e lehtë e pjesëmarrjes së kësaj grupmoshe në vitet e pastajme, gjë që si trend pritet të vazhdojë. Në suaza të kësaj grupmoshe, vlerësohet se pjesëmarrja e atyre mbi 65 vjeç, do të dyfishohet gjatë 5 dekadave të ardhshme.

Tabela 1: Dinamika e numrit të pensionistëve

Viti	2001	2005	2010	2015	2020	2025	2030	2035	2040	2045	2050
Mbi moshën 65 vjeç	131,548	146,436	174,732	209,529	249,456	297,499	334,890	374,888	427,772	500,032	586,085
Pjesëmarrja në numrin total të popullatës	5.8%	6.0%	6.6%	7.4%	8.2%	9.1%	9.6%	10.0%	10.7%	11.9%	13.2%

Burimi: Vlerësimet e UNMIK-ut

Në projeksionet e zhvilluara lidhur me shtimin e popullësisë parashihet një rritje e popullësisë mbi 65 vjeç, me normë mesatare vjetore nga 3% deri në 4%. Trendet e tilla të rritjes relative të popullësisë së moshuar (mbi 65 vjeç) flasin për nevojën e ndërtimit të një sistemi konzistent pensional, i cili në kushtet e ekonomisë së tregut do jetë në gjendje të ofrojë mbështetje substanciale për pensionistët.

Mirëpo, për dallim prej shumë vendeve, ku mplaçja e popullësisë shënon një presion të madh në fondet e pensioneve, në Kosovë edhe më tutje do të mbetet relativisht e ulët pjesëmarrja e personave në moshë mbi 65 vjeç, gjë që në kontekstin e problemeve të mëdha në ndërtimin e fondeve të pensioneve në Kosovë paraqet një rrethanë lehtësuese.


3.2. Gjendja sociale dhe pozita e pensionistëve aktualë

Instituti Riinvest, në muajin tetor të këtij viti, ka anketuar 110 pensionistë nga 7 regjione të Kosovës, të cilët kanë realizuar pensione në sistemin e kaluar. Mostra ka përfshirë pensionistë të pleqërisë, pensionistë me pensione të beneficuar, pensionistë invalidorë dhe ata që gëzojnë pensione familjare. Anketimi është bërë në një mostër me zgjidhje të rastësishme.

Mbi 60% e të anketuarve ishin të moshës mbi 65 vjeç. Nga të dhënat e anketës del se pjesa më e madhe pensionistëve (51,52%) jetojnë në familje me mbi 7 anëtarë, ndërsa të vetëm ishin vetëm 3.64%. Pjesa më e madhe e tyre jetojnë në shtëpi ose banesë (90%). Nga pensionistët e anketuar, 4,55% nuk e kanë të zgjidhur problemin e banimit, 2,73% nuk kanë dhënë përgjigje, kurse 2.73% kanë shtëpi ose banesë. Prej të anketuarve, 95.45 % deklarohen se tani nuk e realizojnë pensionin e tyre.

Burimet kryesore të ekzistencës së pensionistëve janë ato nga anëtarët e familjes. Struktura e këtyre burimeve shifet më së miri nga rezultatet e anketës:

Burimet për ekzistencë të pensionistëve



Burimi: Anketa e Institutit Riinvest

Për gjendjen shumë të rëndë të pensionistëve flet edhe fakti mbi pozitën materiale të familjes së tyre, ku ata jetojnë. Në pyetjen se kush nga anëtarët e familjes realizojnë të ardhura, pensionistët përgjigjen se në 42.73% të ardhura (të rregullta) nuk realizon asnjë anëtar i familjes, në 53,64% të rasteve realizon një anëtar, kurse në 3.64% të rasteve dy apo tre anëtarë.

Shumica e pensionistëve të anketuar, mbi 90%, rëndësi parësore në shpenzimin e të ardhurave i jep ushqimit, kurse veshëmbathja, rryma dhe gjërat e tjera janë me prioritet më të vogël. Rreth 7% të buxhetit të tyre, pensionistët e shpenzojnë për barna dhe për nevoja të tjera.

Boksi 2: Intervistë me një amvise pensioniste

Jam 54 vjeçare dhe me të drejtë më takon pensioni i llojit - pension familjar - pasi që burri më ka vdekur, unë duhet ta gëzojë këtë pension, si bashkëshorte e tij. Pensionin e kam marrë deri në dhjetor të vitit 1999, pra deri pak para fillimit të luftës. Ndërsa me përfundimin e luftës dhe me kthimin tone në shtëpitë tona kjo çështje, me sa e din unë, as nuk është diskutuar se jo të marrim pensione.

Pensioni më ka takuar në vitin 1982, vetëm 2-3 muaj pas vdekjes së bashkëshortit. Në atë kohë me të vërtet kam pasur nevojë për këtë pension, pasi që burri më ka lënë në kohën kur më është dashur më së shumti, në kohën kur fëmijët sapo filluan të rriteshin. I kisha 5 fëmijë, madje të gjithë djem. Në fillim kam menduar se s'do të mund t'i rriti as 3 prej tyre, mirëpo zoti dashti dhe une i kam të gjithë të zotët e vetit. Pra deri në atë kohë kur fëmijët e mi kanë qenë të varur nga une, unë edhe e kam marrë pensionin, ndërsa sot ata punojnë dhe më mbajnë mua. Gjendjen nuk e kam edhe aq të rrezikuar për të jetuar, mirëpo gjendjen shëndetësore nuk e kam të mire dhe përherë më duhet t'u kërkojë para fëmijëve. Prandaj edhe më brengos fakti pse çështjen e pensioneve nuk e diskutojnë fare. Ku është djerësa e punëtorëve të dikurshëm. Kisha me cekë edhe atë se pa marrë parasysh se mua më punojnë fëmijët, por jo të gjithë, vetëm 2 prej tyre, me të ardhura mesatare, ndërsa jemi 6 në familje, jeta është shumë e shtrenjë dhe vështirë t'ia dalim në krye. Po të kisha pensionin, sado i vogël që të ishte, vetëm nevojat e mija personale po të mi mbulonte, unë do të isha e kënaqur.

Unë mendoj se ekzistojnë mënyra të ndryshme për sigurimin e një fondi të pensionistëve. Në rradhë të parë mendoj, se duhet ndarë një përqindje nga doganat dhe tatimet për fond të pensionistëve, pastaj nga kontributet në të ardhura të punëtorëve aktualë. Ekzistojë edhe forma të tjera të cilat mua nuk më kujtohen për momentin, apo më mire të them se nuk jam edhe aq e njoftuar se cilat janë format adekuate për krijimin e një fondi të tillë, pasi që edhe nuk jam e shkolluar, pra jam një amvise. Mirëpo megjithatë e di se me ligj duhet të parashihen të gjitha këto, dhe vetëm me nxjerrjen e një ligji të tillë, ku do të perfshihen pensionet në mënyrë sa më reale, pensionistët do të jenë më të rehatshëm.

Mbi 65% e pensionistëve, sipas deklaramit në anketë, ndodhën në një gjendje jo të mirë apo të keqe shëndetësore. Kujdesin shëndetësor për ta në rastet më të shpeshta e bart familja dhe të afërmit, (rreth 83%), kurse pjesëmarrja e entit social sillet rreth 11% të rasteve. Një numër shumë i vogël i tyre merr pensione nga jashtë (2,75% të numrit të anketuarve).

Boksi 3: Intervistë me një arsimtare të pensionuar

Respondetja e intervistuar M.H është rreth të gjashtëdhjetave dhe është pensionuar në vitin 1991. Ka shërbyer 30 vjet në arsim si mësuese, në vendet e ndryshme të Kosovës. Vitet e para të pensionimit ka qenë mbajtëse e familjes. Gjatë viteve 1991-1998 pensioni më i madh i realizuar ka qenë 150 DM, ndërsa më i vogli 3 DM.

Lloji i pensionit të cilin e realizon respondentja është pension I parakohshëm. Shkaku i pensionimit të parakohshëm ka qenë sigurimi i të ardhurave, pasi që në atë kohë arsimit kosovar ballafaqohej me vështirësi financiare, që kanë qenë pasojë e dëbimit të nxënësve shqiptarë nga shkollat e tyre.

Pasi që më shumë se dy vite nuk realizon pensionin e merituar, respondentja mbështetet në pagat e fëmijëve. Në pyetjen se çka nëse nesër duhet të kujdeset për vete, ajo me dëshpërimit thotë: *do të detyrohesha që edhe në këtë moshë të shtyrë të punoja çfardo pune, sa për të mbetur gjallë.*

Respondetja thotë se i mungon kolektivi në të cilin ka punuar, por edhe thekson mungesën e kujdesit adekuat të shoqërisë, ndaj kësaj shtrese të rrezikuar.

Një pjesë të kohës së lire ajo e kalon në Shoqatën e gruas pensioniste-VITA, ku shoqërohet me bashkëmoshataret e veta; vizitojnë vende të ndryshme të Kosovës dhe diskutojnë për çështjet që i preokupojnë ato.

Është pjesërisht e informuar lidhur me skemën e re pensionale, ndërsa si burim i informimit i veçon mediat, sidomos ato elektronike.

Respondetja mendon se ka munguar angazhimi i UNMIK-ut lidhur me pagesat e pensioneve, ndërsa pagesën e pensioneve vetëm për persona mbi 65 vjeç e sheh si të mangët, pasi që i duhet të pres edhe disa vjet që të përfshihet në këtë grup. Ajo mendon se problemi mund të zgjidhet me kthimin e mjeteve të tjetërsuara nga Serbia, me të ardhurat e realizuara nga tatimet dhe doganat, si dhe me një angazhim më të madh të faktorit ndërkombëtar dhe lokal në këtë drejtim. Në fund ajo shprehet që kjo intervistë të ketë efektin e duhur dhe të ndihmojë sa do pak që ajo të marrë pensionin e merituar.

Në suaza të përgatitjes së raportit studimor, ekspertët e institutit “Riinvest” kanë zhvilluar kontakte pune me përfaqësuesit e Shoqatës së Pensionistëve të Kosovës dhe me përfaqësuesit e Shoqatës së Pensionistëve Invalidorë. Ndër vërejtjet themelore të tyre lidhur me skemën e re pensionale, e cila është në përgatitje e sipër nga UNMIK-u ishte ajo mbi lartësinë e pensionit dhe mospërfshirjen në këtë skemë të pensionistëve invalidorë. Një problem shumë i rëndë që kërkon trajtim të veçantë është ai i individëve, të cilët më parë kanë gëzuar të drejtën e pensionit, ndërsa tani nuk e kanë moshën 65 vjeç, e cila moshë është kusht për pensione të pleqërisë. Mbi këtë bazë, sidomos, do të dëmtohen rreth 28.000 pensionistë invalidorë. Kështu që disa prej tyre mund të kualifikohen për asistencën e përgjithshme sociale e cila ofrohet nga Departamenti i Punës dhe Mirëqenies Sociale. Kësaj çështje duhet t’i kushtohet vëmendje e posaçme politike në të ardhmen.

3.3.Sistemi i ri i pensioneve në Kosovë

Gjendja aktuale e të moshuarve dhe e atyre që së shpejti do të kualifikohen për pension shtron nevojën urgjente për ndërtimin e sistemit të pensioneve.

Kosova momentalisht nuk ka sistem pensional i cili funksionon, gjë që është karakteristikë veçuese përkundrejt vendeve të tjera. Në këto kushte, ndërtimi i këtij sistemi do të bëhet mbi baza krejtësisht të reja. Janë rrethanat reja ekonomike, të bazuara në rregullimin ekonomik sipas konceptit të ekonomisë së hapur të tregut, në privatizim dhe ndërmarrësi, në liberalizimin ekonomik, në parimet e shtetit ligjor, drejtësinë sociale dhe në trendet e globalizimit të ekonomisë, ato të cilat duhet të respektohen gjatë ndërtimit të sistemit të ri pensional.

Rrethanat vështirësuese në ndërtimin e Sistemit të Pensioneve janë burimet e kufizuara për pensione si pasojë e nivelit të zhvillimit ekonomik, normës së lartë të papunësisë dhe pasojave të luftës.

Çështja e pagesës/mospagesës së pensioneve është problem me të cilin opinioni kosovar është tejet i preokupuar, mirëpo dialogu për zgjidhjet e reja dhe problemet përcjellëse mungon në masë të duhur. Nga anketa me pensionistët shifet se ata nuk janë sa duhet të informuar lidhur me ndryshimet aktuale në sistemin e pensioneve. Rezulton fakti se rreth 30% nuk janë fare të informuar, kurse 50% informohen nga mediat e vetëm 21% nga Shoqata e Pensionistëve.

Skemat pensionale të ndërtuara në shtetet në tranzicion kryesisht janë treshtyllore. Një skemë e tillë iu përgjigjet edhe kushteve tona. Ajo do të përfshinte këto shtylla:

1. Pensionet bazë (të pleqërisë);
2. Pensionet në bazë të kontributeve të cilat do të kapitalizoheshin;
3. Rregullimin vullnetar të pensioneve, përmes kontributeve shtesë të firmave dhe individëve.

Sistemet e sigurimit pensional dallohen nga mënyra se si financohen pensionet. Në praktikë dallohen dy forma themelore të financimit të pensioneve, sistemi PAYGO (Pay as you go), dhe sistemi i fondeve në tërësi ose sistemin e kursimeve për pensione.

Të gjithë parametrat flasin se ekziston arsyeja e plotë që sistemi i ri i pensioneve në Kosovë të ndërtohet mbi bazën e kontributeve të llogarive individuale. Avantazhet dhe të metat e këtij sistemi janë të njohura nga përvojat e vendeve të tjera. Sistemi më i njohur i llogarive individuale është ai i Kilit. Në Europë ky sistem është aplikuar ose është duke u aplikuar, për shembull Poloni, Kroaci, Hungari, Suedi, Letoni. Kontributet në këtë sistem janë investuar në portfolion financiare, ndërsa niveli i përfitimit pensional varet nga kontributet e paguara dhe nga përfitimet e realizuara nga investimet e këtyre fondeve.

Nga anketa me pensionistët, bisedat me përfaqësuesit e Shoqatës së pensionistëve, me përfaqësuesit e Fondit të Sigurimeve pensionale e Invalidore si dhe me disa ekspertë të kësaj fushe dolën shumë propozime për gjenerimin e fondeve për sigurimin e pensioneve në Kosovë. Ata, si burime të mundshme, përmendin kontributet në të ardhurat personale, të hyrat e përgjithshme, akcizën, donacionet e jashtme, ndarjet nga procesi i privatizimit të ndërmarjeve shoqërore (30 – 35 %).⁷ Vlen të theksohet se burim i vetëm për sigurimin e fondeve për pensione, sipas rregullativës së vjetër ligjore, ishin kontributet të cilat karakterizoheshin me normë relativisht të lartë prej 16% - 21,66%, me gjithë faktin se niveli i beneficioneve në sistemin jugoslav ishte relativisht i lartë, përfshierja ishte e vogël – të gjithë të moshuarit nuk kanë mundur të marrin pjesë në sistemin e vjetër të pensioneve.

Duket e drejtë politika e UNMIK-ut që për pensionet bazë të qytetarëve të sigurojë mjetet nga të hyrat e përgjithshme, ndërkaq për pensionet e shtyllës së dytë dhe të tretë fondet duhet të sigurohen përmes kontributeve. Duke pasë parasysh kapacitetet e limituara të buxhetit të Kosovës, i cili mund të mos jetë në gjendje të sigurojë pagesën e pensioneve bazë në nivelin e sigurimit të minimumit të jetesës, angazhimi i një përqindje të caktuar të mjeteve, që realizohen nga procesi i privatizimit, duket si një mundësi e mirë.

Në disa vende në tranzicion po praktikohet që një pjesë e fondeve, që siurohen nga privatizimi i ndërmarjeve shtetërore, të orientohen për pensione. Në Kosovë, pensionistët kanë kontribuar në ngritjen, zgjerimin dhe afarizmin e ndërmarjeve ekzistuese si punëtorë të mëparshëm të tyre. Në këto vlera kanë kontribuar edhe qytetarët e tjerë, (bujqit, ushtruesit e veprimtarive të pavarura ekonomike, punëtorët e arsimit, të administratës shtetërore etj), të cilët përmes

⁷ Pensionistët e anketuar konsiderojnë se zgjidhja e pensioneve duhet të bëhet duke u aplikuar kontributet në të ardhura të punësuarëve aktualë (64,55% e tyre), përmes krijimit të fondeve nga privatizimi i ndërmarjeve shoqërore (13,64%) dhe përmes formimit të një fondi të posaçëm, i cili do të financohej nga tatimet, doganat, kontributet etj

3.4. Burimet e gjenerimit të fondeve për pensione

tatimeve dhe obligimeve të tjera fiskale kanë ndihmuar në ngritjen e përgjithshme të infrastrukturës ekonomike dhe joekonomike në Kosovë. Prandaj orientimi i një pjese të mjeteve nga privatizimi, e cila sipas përvojave në vendet e tjera sillet nga 20-30%, do të shfrytëzohej si pjesë suplementare për pensionet bazë (të pleqërisë). Me këte do të ndihmohej që lartësia e këtyre pensioeve të ngritet mbi nivelin që mund ta përballojë buxheti i Kosovës. Këto fonde do të alimentoheshin si pjesë e veçantë në buxhet, të destinuara për plotësimin e pensioneve të pleqërisë dhe do të shtoheshin krahas zhvillimit të privatizimit, përkatësisht transformimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë.

Burimet e gjenerimit të fondeve për financimin e pensioneve do të varen nga lloji i shtyllave të pensioneve:

1. ***Shtylla e parë – Pensionet e pleqërisë do të financohen nga:***
 - të hyrat e përgjithshme të buxhetit të Kosovës;
 - në të ardhmen mund të shfrytëzohen mjetet nga privatizimi;
2. ***Shtylla e dytë- Pensionet në bazë të kontributeve do të financohen nga:***
 - kontributet e detyrueshme të punëtorëve prej 5% nga pagat
 - kontributet e detyrueshme të punëdhënësve prej 5% nga fondi i pagave të punëtorëve;
 - përfitimet nga investimi (kapitalizimi i kursimeve individuale).
3. ***Shtylla e tretë – rregullativa vullnetare do të financohet nga:***
 - kontributet vullnetare të individëve;
 - kontributet shtesë të firmave për punëtorët e vet
 - përfitimet nga kapitalizimi i këtyre kursimeve.

3.5. Tiparet e sistemit të kursimeve pensionale

Karakteristika themelore e sistemit të kontributeve qëndron në përcaktimin e shkallës së kontributeve, pa definimin paraprak të një nivelit të synuar të kompensimit pensional. Kontributet në praktikë më së shpeshti caktohen në një përqindje fikse në raport me pagën; ato paguhen në një institucion të specializuar, i cili investon këto mjete të grumbulluara. Skema e kontributeve manaxhon me kursimet pensionale në emër të individit. Me rastin e pensionimit, qoftë mbi bazën e pleqërisë apo të paaftësisë për punë, kursimet e përgjithshme pensionale shërbejnë për të blerë kompensimin e nevojshëm pensional. Është renta e përjetshme ajo e cila njihet si formë themelore e një kompensimi të tillë.

Avantazhet themelore të këtij sistemi janë:

- Lidhja e fortë ndërmjet kontributeve dhe beneficioneve – mjetet konsiderohen si pronë për të siguruarit;
- Përmirësohet stimulimi i pjesëmarrjes dhe përgjegjësia individuale;
- Niveli i kthimit të mjeteve është i lartë;
- Ndikimi neutral i varshmërisë demografike ndaj pensioneve individuale;

- Mundëson kursimet private dhe zhvillimin ekonomik.

Sidoqoftë, procesi i marrjes së vendimeve duhet t'i marrë parasysh edhe faktorët që lidhen me funksionimin e fondit të shtyllës:

- Pasiguria e lartë lidhur me nivelin real të pensioneve të ardhshme; ky nivel është i varur nga rezultatet afatgjate të investimeve të kontributeve të ndara;
- Pensionistët në bazë të këtij sistemi nuk janë mjaft të siguarar rastin e pensionimit nga paaftësia në punë, sidomos në rastet kur kanë punuar një kohë shkurtë;
- Shpenzimet administrative në përgjithësi të larta.⁸

Gjatë vitit 2001 problemi i pensioneve ka qenë objekt trajtimi në AQF dhe në organe të tjera të UNMIK-ut, Bankës Botërore dhe nga Organizata Ndërkombëtare e Punës. Në raportin e prezentuar⁹ të ILO dhe UNMIK-ut bëhet një vështrim i rëndësishëm mbi gjendjen e pensionistëve dhe parakushteve për ndërtimin e sistemit të ri të pensioneve. Nga aspekti social ky problem ka zënë vend edhe në raportin e Bankës Ndërkombëtare¹⁰ mbi vlerësimin e varfërisë në Kosovë, të hartuar në tetor të këtij viti.

Në ndërtimin e sistemit të ri të pensioneve është angazhuar edhe Fondi i Sigurimeve Pensionale dhe Shoqata e Pensionistëve, duke ofruar shërbimet e tyre profesionale dhe bazën e të dhënave mbi problemet e pensionistëve ekzistues.

UNMIK- u, përkatësisht Autoriteti Qendror Fiskal i Kosovës, gjatë këtij viti, ka punuar intensivisht rreth krijimit të skemës pensionale në Kosovë. Në përcaktimin e politikave në këtë fushë synohet një shkëputje radikale nga sistemi i vjetër i pensioneve, duke krijuar një skemë të re, të bazuar në përvojat e vendeve perëndimore dhe të atyre në tranzicion. Me këtë vendosen themelet e një sistemi të qëndrueshëm, i cili fillimisht nuk do të sillte shumë beneficione për pensionistët kosovarë, por me kalimin e kohës efektet e tij do të rriten dhe Kosovën do ta kursente nga shumë probleme dhe kundërthënie nëpër të cilat kanë kaluar dhe po kalojnë shumë vende në zhvillim dhe ato në tranzicion.

Në politikat e definuara të AQF-së, lidhur me skemën pensionale të Kosovës, si dhe në projekt Regulloren për pensionet në Kosovë është përcaktuar që sistemi i pensionit të Kosovës të përbëhet nga tri shtylla:

3.6. Aktivitetet aktuale në ndërtimin e sistemit të pensioneve

⁸ Duhet të merren parasysh krahasimet ndërmjet shpenzimeve administrative dhe sistemit PAYG, mirëpo, kthimi i mjeteve neto për të dy sistemet, po ashtu, nuk duhet të lihet anash.

⁹ ILO dhe UNMIK: Strategjia e mbrojtjes sociale në Kosovë, NË DREJTIM TË STRATEGJISË SË SIGURIMIT SOCIAL, Prishtinë, 25 shtator 2001

¹⁰ Banka Botërore: KOSOVA, Vlerësim i varfërisë, 3 Tetor 2001

1. Shtylla e parë do të ishte “pensioni bazë” , i cili do të ishte pensioni që administrata e pensionit ua paguan të gjithë qytetarëve të Kosovës që arrijnë moshën mbi 65 vjeçare. Ky lloj i pensionit do të të financohej nga të hyrat e përgjithshme të buxhetit të Kosovës dhe do të administrohej nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
2. Shtylla e dytë do të ishte një sistem i obligueshëm i pensioneve nga kontributet e punëdhënësve dhe punëtorëve, që në formë të kursimeve do të menaxhohej nga Trusti i Kursimeve të pensioneve të Kosovës, dhe do t’u paguhej të gjithë puntorëve të cilët mbushin moshën mbi 65 vjeçare. (pensioni i kursimeve individuale).
3. Shtylla e tretë do të ishin skemat shtesë të kontributeve vullnetare për punëtorë në skema të angazhuara nga punëdhënsi dhe për pjesëmarrës të skemave individuale. (pensioni shtesë i punëdhënsit dhe pensioni shtesë individual)

3.7.

3.7. Pensioni i bazë

Administrata Pensionale dhe e Beneficioneve (e themeluar si njësi administrative në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale) do t’u paguajë pensionin bazë të gjithë qytetarëve të Kosovës që arrijnë moshën 65 vjeçare. AQF-ja do të transferojë mjetet e përgjithshme në administratë për të financuar pensionin bazë, në përputhje me mjetet që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i ndan për këtë qëllim. Ky lloj i pensioneve do të financohet nga të hyrat e përgjithshme të Buxhetit të Kosovës.

Sipas Propozimit të Rregullores, shuma e pensionit bazë përcaktohet sipas metodologjisë së miratuar nga Parlamenti, duke zbatuar normën e njejtë për të gjithë pensionistët që kanë fituar të drejtën për pensionin e moshës së shtyrë. Metodologjia e përcaktimit të nivelit të beneficioneve për çdo vit do të propozohet në Parlamentin e Kosovës për aprovim.

Logjika e këtij pensioni qëndron në atë që të gjithë të moshuarit të marrin të ardhura të mjaftueshme, në mënyrë që të mos bien nën nivelin minimal të varfërisë dhe të mund ta përballojnë konsumin bazik dhe të kontribuojnë në buxhetin e familjes së tyre. Mendohet se me këtë lloj të pensionit të moshuarit do të sigurojnë mjete minimale për të përballuar shpenzimet e tyre për ushqim. Është e evidente se në vitet e para niveli i këtij pensioni mund të jetë edhe më i ulët se sa çmimi i shportës, nëse mjetet në dispozicion në buxhet janë shumë të kufizuara.

3.8. Pensioni i Kursimeve Individuale

Rregullorja e propozuar parasheh që për administrimin e pensioneve nga kursimet individuale do të formohet trusti i kursimeve pensionale i Kosovës. Trusti do t’i administrojë llogaritë individuale të pensioneve për punëtorët. Ai do të veprojë si etnitet juridik i veçantë dhe jofitimprurës, i ndarë nga UNMIK-u. Trusti siguron investimin e kursimeve dhe ruajtjen e mjeteve të pensioneve. Ai

paguan pensionet e kursimeve dhe vepron në emrin e pjesëmarrësve. Ky do të menaxhohet nga një bord i veçantë për qeverisje, i cili do të përbehet nga kryesuesi i AQF-së, përfaqësuesi i punëdhënësve, përfaqësuesi i punëmarrësve dhe nga katër ekspertë, të cilët kanë përvojë ndërkombëtare në manaxhimin e mjeteve.

Pagesa e kontributeve të këtij lloji pensioni, sipas propozim Rregullores, është e obliguar si për punëdhënësit ashtu edhe për punëtorët. Obligimi fillon me ditën e parë të fillimit të punës së punëtorit të punëdhënësi. Shuma e kontributeve për financimin e pensioneve të kursimeve kap shumën 10% të pagave. Punëdhënësit paguajnë pesë përqind (5%) të pagave të tërësishme të të gjithë punëtorëve si dhe punëtorët paguajnë pesë përqind (5%) të pagës së tij. Në bazë vullnetare, edhe punëdhënësi, por edhe punëtori, mund të paguajnë përqindje më të madhe se sa përqindja e cekur më lart.

Bordi për qeverisjen e trustit do t'i përcaktojë instruksionet, duke përfshirë pjesën e mjeteve që do të investohen në vend dhe jashtë dhe mënyrat për sigurimin e investimeve më të matura për gjeneratat më të vjetra do t'i përcaktojnë administruesit e besueshëm. Mjetet do të manaxhohen në një kompani e cila përzgjidhet përmes tenderit. Bordi për qeverisje miraton udhëzime të qarta të investimit të mjeteve, duke përfshirë standardet me të cilat kufizohen investimet vetëm në instrumentet që konsiderohen të matura për investimet e pensioneve. Trusti gjithashtu do të përzgjedhë kujdestarët përmes tenderit. Kujdestari mund të jetë bankë, që ka statusin e personit juridik, e licencuar në Kosovë ose filial i bankës së huaj, e autorizuar që të zhvillojë biznes dhe e licencuar nga ndonjë rregullore bankare e shtetit, i cili është anëtar i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). Që në të dy rastet duhet t'i plotësojë kushtet që i parashtron BPK-ja në rregullimin e veprimit bankar.

Projekt Rregullorja, gjithashtu, rregullon mënyrën e pagesës së pensioneve të kursimeve dhe llojet e pensioneve, të cilat do t'i ofrojnë shoqëritë e licencuara të sigurimeve e të cilat mund t'i zgjedhë secili person që mbrin moshën e pensionit e që ka të drejtë në pensionin e kursimeve. Procedurat e licencimit të këtyre shoqërive përcaktohen nga AQF-ja.

Sipas projekt Rregullores së pensioneve janë paraparë mundësi relativisht të gjëra për investime nga fondet e kursimeve pensionale. Qëllimet e investimeve janë:

- Sigurimi i mjeteve të pensionit;
- Shumëllojshmëria e investimit;
- Fitimi maksimal i qëndrueshëm me sigurinë e mjeteve të pensionit; dhe
- Ruajtja e likuiditetit të mjaftueshëm.

Mjetet te cilat do te grumbullohen në vitet e ardhshme shifen nga tabela vijuese

Tabela 4: Kontributet në Trustin e pensioneve¹¹

Subjektet	Paga mesatare në 2001 DM	2002		2003		
		Nr. i kontribuesve	Kontribute të përgjithme vjetore DM	Nr. i kontribuesve	Kontributet e përgjithshme vjetore DM	Mjetet totale në vitin 2003 (me rritje 3%)
Nd.shoqërore	250	50,000	12,500,000	50,000	15,000,000	27,875,000
Nd. Publike	330	15,000	4,950,000	15,000	5,940,000	11,038,500
Qeveria	260	55,000	14,300,000	55,000	17,160,000	31,889,000
Org.ndërkom/OJQ	800	1,000	800,000	1,000	960,000	1,784,000
Bizniset e vogla	350			130,000	54,600,000	54,600,000
Te vetëpunësuarit	100			100,000	12,000,000	12,000,000
Gjithsej		121,000	32,550,000	351,000	105,600,000	139,186,500

Burimi: Të dhënat e Autoritetit Qendror Fiskal të Kosovës.

Mundësitë e angazhimit të këtyre mjeteve në institucionet dhe instrumentet financiare ndërkombëtare, sipas projektrregullores do të jenë:

- Mjetet monetare, duke përfshirë llogaritë bankare dhe depozitat në banka që i liçencon organi rregullativ bankar i shtetit, anëtar i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim;
- Letrat me vlerë që i emeton shteti, anëtar i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim;
- Letrat me vlerë që i emetojnë qeveritë lokale në shtetet, anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, në masën që e garanton shteti përkatës;
- Letrat me vlerë të regjistruara në rregullatorin e tregjeve të kapitalit të çdo shteti anëtar i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim; dhe
- Fondet e përbashkëta dhe të investimit, varësisht nga miratimi në shtetin institucionit brenda shtetit anëtar i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

Në Kosovë mjetet e kursimeve pensionale do të mund të investohen si vijon:

- Mjetet monetare, duke përfshirë llogaritë bankare dhe depozitat në banka, që i liçencon BPK-ja, por që nuk janë nën masat e detyrimit dhe që nuk janë lëndë e pezullimit të liçencës së tyre;
- Letrat me vlerë, që i emeton Qeveria e Kosovës, në masën e garantuar nga Qeveria e Kosovës;

¹¹ Janë dhënë të ardhurat reale, pa llogaritur inflacionin.

- Letrat me vlerë të ndërmarrjeve (duke përfshirë, por pa i kufizuar aksionet dhe obligacionet), të regjistruara në rregullatorin e tregjeve kapitale të Kosovës dhe të plasuar përmes ofertës publike, me kusht që letrat e tilla me vlerë të jenë kuotuar në bursën e letrave me vlerë në Kosovë ose në ndonjë jurisdiksion tjetër të shtetit, anëtar i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim; dhe
- Fondet e përbashkëta dhe të investimeve, varësisht nga miratimi i rregullatorit në Kosovë.

Vlerësohet se investimi i këtyre mjeteve, gjithsesi do të jetë një nxitje e rëndësishme në:

- Lehtësitë në krijimin dhe zhvillimin e tregut vendor të kapitalit dhe
- në nxitjen e aktiviteteve investuese, veçanarisht në sektorin e NVM-ve, sektor ky i cili po tregon performansa të kënaqshme për investime dhe disiplinë korrekte në kthimin e kredive të marra nga bankat dhe institucionet e tjera financiare jobankare.

Propozim Rregullorja, po ashtu, definon metodat e pagimit të pensioneve përmes kompanive të licencuara të sigurimeve; kompanitë e tilla do të mund të zgjedhin personat të cilët do të marrin pensionet që atyre u përgjigjen. Procedura e licencimit të këtyre kompanive do të determinohet nga Autoriteti Qendror Fiskal i Kosovës.

Kjo shtyllë e pensionit formohet nga kontributet vullnetare. Pensionet suplementare të punëdhënësit dhe ato individuale do të qeverisen nga Departamenti i veçantë i pensioneve në BPK. Departamenti do të licenconte dhe mbikqyrte fondet suplementare për pensionet e punëdhënësit dhe ato individuale, do të kishte të drejtë të ndërpresë dhe anulojë licencimin e fondeve, të rishikojë raportet vjetore të tyre, të lëshojë rregulla në përputhje me rregulloren e pensioneve dhe të kryejë edhe punë të tjera të rëndësishme për mirëvajtjen e fondeve.

Për të siguruar pensione suplementare të punëdhënësit, do të duhej të krijonin fondet suplementare për pensionin e punëdhënësit. Fondi do të duhej të kirijohet nëpërmjet të një akti themelues, i cili nënshkruhet nga organi më i lartë qeverisës i punëdhënësit. Departamenti i Pensioneve i BPK-së do të aprovojë përmbajtjen e çdo akti themelues, duke kërkuar që ai të përmbushë kërkesat e përcaktuara nga Departamenti. Asetet e pensionit të Fondit rrjedhin nga kontributet e bëra nga ose në interes të pjesëmarrësve të Fondit dhe investimet e bëra me ato kontribute. Në Projekt Rregulloren për pensionet suplementare të punëdhënësit janë të rregulluara edhe licencimi i këtij lloji pensioni, mënyra dhe kushtet e investimeve nga ky fond, zgjedhja e kujdestarit të këtyre pensioneve, mënyra e transfertës si dhe mënyra e përfundimit të fondit.

3.9.Pensionet suplementare të punëdhënësit dhe ato individuale

Personat fizikë, në bazë të Projekt Rregullores, mund të krijojnë një pension suplementar individual për vetën e tyre. Këtë do të mund ta bënin duke lidhur kontratë me një bankë të licencuar, një tjetër institucion financiar apo një kompani sigurimesh të licencuar. Insitucionet financiare që ofrojnë pensione individuale suplementare duhet t'i kenë të përshkruara këto pensione në rregullat e tyre të pensionit. Projekt Rregullorja ofron kornizën rregullative për pensionet suplementare individuale, transfertën e këtyre pensioneve, si dhe mënyrën e përfundimit të pensioneve suplementare individuale.

**4.PËRVOJAT E
SISTEMIT DHE
POLITIKËS
PENSIONALE NË
VENDET E TJERA**

Me qëllim të gjetjes së rrugëzgjdhjeve për ndërtimin e një sistemi të qendrueshëm pensional, veçanarisht janë trajtuar disa përvoja në vendet e Unionit European si dhe ato të shteteve në tranzicion. Qëllimi është që sistemi i cili do të ndërtohet në Kosovë, të ketë sa më pak karakter tranzitor, sepse interesat ekonomike të Kosovës janë të lidhura me shtetet e Unionit European dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me të cilat është e nevojshme të harmonizohet edhe sistemi dhe politika e pensioneve.

Sistemi aktual i pensioneve në vendet e Unionit European, sikurse edhe në shumicën e shteteve në tranzicion, bazohet mbi skemën “Pay- As-You-Go”. Esenca e këtij sistemi qëndron në atë se gjenerata e tanishme e të punësuarve përmes kontributeve të tyre financon kompensimet pensionale të pensionistëve ekzistues. Në bazë të pagave dhe kontributeve të tyre, të punësuarve u llogariten pensionet e ardhshme, të cilat do t'i financojnë brezat e ardhshme. Për këtë arsye ky sistem njihet edhe si sistem i solidaritetit të ndërgjeneratave. Edhe pse të siguruarit në kuadër të një gjenerate gjithmonë përballojnë risqet demokrafike dhe ato ekonomike, ajo që karakterizon sistemin PAYGO është solidariteti i shprehur në mes të gjeneratave të ndryshme.

Ndërrimi i strukturës së vjetërsisë së popullësisë, si faktor i rëndësishëm ekonomik dhe social, ka zënë vend të rëndësishëm në analizat dhe projeksionet ekonomike në shumicën e shteteve në botë. Proceset më karakteristike janë ato të rënies së fertilitetit në një anë dhe të zgjatjes së jetës, në anën tjetër, pra i mplakjes së popullësisë. Nga projeksionet e Bankës Botërore¹² mund të vërehet një trend i rënies së fertilitetit në të gjitha regjionet e botës. Fertiliteti në vitin 2040 parashihet të sillet rreth 2 në shtetet e OECD-së, Europën Qendrore dhe Lindore dhe Azisë, ndërsa 2.5 në shtetet e Afrikës. Rënia më e madhe do të shënohet në shtetet e Afrikës dhe ato Latino Amerikane, tek të cilat fertiliteti në vitin 1970 ishte 6.8, ndërsa në vitin 2000 në shtetet e Afrikës ishte 5.0, ndërsa në ato Latino amerikane 3.3.

¹² Robert Palacias and Monserrat Pallares-Millares: International Patterns of Pension Provision, World Bank, April 2000.

Zgjatja e jetës së popullësisë në shtetet e OECD-së parashihet të arrijë nga 78 vjeç, sa ishte në vitin 2000 në 84 vjeç në vitin 2040. Gjatë kësaj periudhe, tek shtetet e Europës Qendrore parashihet të zgjatet jeta nga 65 vjet në 75 vjet, kurse në shtetet e Afrikës nga 44 në 64 vjet.

Vlerësohet se tani në UE punojnë mbi 4 të punësuar për çdo person mbi moshën 65 vjeçare. Projektionet e bëra në suaza të UE flasin se në vitin 2030 ky proporcion do të bie në 2:1, ndërsa në vitin 2050 proporcioni vlerësohet se do të jetë 1,5:1. Në bazë të të dhënave statistikore rezultojnë të jenë rreth 16% e popullatës së Europës Perëndimore mbi 65 vjeç, ndërsa vlerësimet për vitin 2030 flasin se do të jenë mbi 25%. Sipas vlerësimeve të OECD-së, vlerësohet se në Gjermani në vitin 2040 pjesëmarrja e kësaj grupmoshe do të rritet në 40%.

Tabela 6: Taksat për sigurimin social në disa vende¹³ e OECD-s në mesin e viteve 1990-ta

Vendet	Si përqindje e pages brutto			
	Taksat pensionale		Taksat e përgjithshme sociale	
	Punëdhënësi	Punëmarrësi	Gjithsej	Taksa e përgjithshme të sigurimit social
SHBA	6.2	6.2	12.4	21.0
Austria	12.6	10.3	22.8	45.0
Kanada	3.0	3.0	6.0	15.2
Gjermania	10.2	10.2	20.3	42.0
Italia	21.3	8.3	29.6	56.7
Japonia	8.3	8.3	16.5	29.1
Holanda	0.0	32.1	32.1	56.0
Suedia	19.0	1.0	20.0	24.9
Zvicra	4.9	4.9	9.8	19.3


Burimi: US Department of Health and Human Services. „Social Security Programs throughout the World“¹⁴ 1997. Robert Palacios and Montserrat Palleres-miralles, International Patterns of Pension Provision, April 2000.

Këto procese imponohen si sfida shumë të mëdha për përballimin e pensioneve të popullatës në moshë të pleqërisë. Për zgjidhjen e problemeve sociale të

¹³ Tabelën e plotë, (me vendet e tjera të OECD-së) e shifni në aneks

¹⁴ Përmes: Robert Palacios and Montserrat Palleres-Miralles: INTERNATIONAL PATTERNS OF PENSION PROVISION, April 2000

popullatës së paaftë për punë në moshë pleqërie, në shumë vende në botë aplikohen dy forma të pensioneve: ato mandatore (të detyrueshme) dhe vullnetare. Marrë në përgjithësi, nga praktika e të gjitha vendeve në botë del se pensionet mandatore realizohen në 49% të rasteve nga sistemi PAYGO (Pay as you go), kurse 51% nga format e tjera.



Shënim: PAYG-“Pay-As-You-Go” sistem i bazuar në transfere. Fonde të pjesërishme – sistemi PAYG me rezerva investive; Fonde të përziera (me më shumë shtylla) –sistem me kontribute investive dhe pensionale.

Burimi: Robert Palacios dhe Monserrat Pallares-Millares: International Patterns of Pension Provision, World Bank, April 2000.

Vlera e pasurive të krijuara vetëm nga sistemi mandatar në vitin 1997 arrinte në 7.500 miliardë dollarë amerikan, ose në 26% të GDP-së globale. Rritja mesatare vjetore e fondeve të pensioneve në periudhën 1990-1996 është realizuar me normë vjetore prej 10.9%.

Tatimi në sigurimin social, në shumicën e vendeve të Bashkimit Europian është i lartë, dhe në shumicën e vendeve është duke u rritur presioni për rritjen e normës tatimore.

Siç shifet nga të dhënat, pasuria e fondeve të pensioneve në Danimarkë, Holanda, Suedi, Zvicër dhe Britani të Madhe tejkalojnë GDP-inë. Fondet në këto vende kanë investuar më shumë në aksione kompanitë e brendshme apo të jashtme, përkundërt investimeve në fletobligacione, proces ky i cili ka dhënë rezultatet më të mira. Në vendet e EU gjithnjë e më tepër po forcohet bindja për paqëndrueshmërinë e sistemit të solidaritetit të gjeneratës.

Holanda në vitin 1996 ka privatizuar plotësisht fondin pensional shtetëror, i cili kishte një kapital prej 140 miliardë dollarë, me 2,5 milionë anëtarë. Në këtë mënyrë Holanda ka privatizuar rreth 85% të fondeve pensionale.

Britania e Madhe ka filluar më 1988 të zbatojë lehtësime tatimore ndaj individëve të cilët investojnë në planet pensionale.

Gjermania është e preokupuar veçmas nga plakja tepër e shpejtë e popullësisë. Problemet me të cilat ballafaqohet ky vend kanë filluar të gjejnë zgjidhje në

investimet përmes fondeve publike investive. Mundësohet themelimi i skemave private të kursimeve, të cilat janë të destinuara për pensionet e ardhshme. Në Gjermani parashihet themelimi i 75 fondeve të pensioneve Altersvorsorge-Sondervermögen (AS), si fonde investive të destinuara për kapitalizmin e kursimeve për pleqëri. Këto kursime shteti i liron nga tatimi, prandaj llogaritet se mbi këtë bazë shteti Gjerman do të sakrifikoj nga buxheti çdo vit për këto qëllime nga 60 miliardë DM. Në vitin 1999 pasuria për pagimin e pensioneve në Gjermani arrinte 590 DM.

Italia në vitin 1998 filloi t'u lejojë bankave dhe kompanive të mëdha të organizojnë planet e tyre private të pensionimit. Kjo pasoi revizionin e plotë të sistemit të pensioneve të kryer në vitin 1995. Me këtë parashihej që planet pensionale mund të investojnë në fondet investive amerikane dhe në letrat me vlerë.

Tabela 5 : **Popullësia dhe pasuria e fondeve të pensioneve në vendet e UE**

Vendi	Nr i banorëve (milion)	Shkalla e aktivitetit ¹⁵	Pasuria e fondeve të pensioneve mlrd. USD	Pasuria e fondeve të pensionit në % GDP
Austria	8,10	22,10	26,7	12
Belgjika	10,20	24,20	32,60	12
Danimarka	5,30	22,40	187,00	198,00
Finlanda	5,20	22,70	60,00	41,00
Franca	59,10	24,60	64,10	4,00
Gjermania	82,00	23,50	294,10	13,00
Irlanda	3,70	16,70	45,90	47,00
Italia	57,70	25,00	250,00	20
Holanda	15,87	18,80	607,00	141,00
Norvegjia	4,50	25,00	49,90	31,00
Portugalia	10,00	22,10	11,80	10,00
Spanja	39,40	23,20	29,10	5,00
Suedia	8,90	26,60	270,50	107,00
Zvicra	7,10	22,40	306,20	117,00
Britania e Madhe	59,40	24,60	144,50	101,00

Burimi: Financial Times, maj 2000

Qeveritë e këtyre vendeve si dhe të vendeve të tjera europiane, me gjithë aktualizimin e reformave pensionale, po prolongojnë ndryshimet më radikale të sistemit të pensioneve. Të nxitur nga nevoja e sigurimit të pensioneve,

¹⁵ Popullata mbi 65 vjeç, si përqindje e popullatës nga 15-64 vjeç.

insitucionet e ndryshme në këto vende kanë intensifikuar zhvillimin e tregjeve plotësuese të pensioneve, veçmas duke investuar në fondet investive pensionale. Prandaj bankat e madha dhe shoqatat e sigurimit gjithnji e më tepër po e zgjetrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e sigurimeve pensionale dhe të planeve të investimeve. Në këtë formë po dëshmohej se sistemi i automatizmit të kontributeve po vjen në krizë dhe dalja nga kjo krizë po kërkohet përmes kursimeve dhe nga buxhetet shtetërore.

4.1.Përvojat e sistemit pensional në vendet në tranzicion

Një ndër tiparet kryesore sociale dhe ekonomike të tranzicionit në vendet e Evropës Qëndrore dhe Lindore kanë qenë krizat në sistemin pensional. Këto kriza kanë sjellur vështirësi ekonomike, politike dhe sociale. Krizat e tilla janë reflektuar me mungesën e fondeve për të paguar pensionet. Përvojat e disa vendeve në tranzicion që kishin të bënin me rritjen e të ardhrave përmes rritjes së taksave dhe deficitit buxhetor u treguan si alternativa shumë të pavolitshme dhe u shprehën keq në deficitin buxhetor dhe në borxhin kombëtar, kurse u shndërruan në barrë të rëndë për reformat ekonomike. Të ballafaquara me këto probleme këto shtete u përcaktuan për reformat pensionale. Nga perspektiva ekonomike, ekzistojnë opsione të ndryshme të reformave në këto vende, dhe nga praktika e tyre nuk mund të haset në ndonjë model të vetëm unik të sistemit pensional.

Nga fundi i vitit 1990, shumica e shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore ndërmorën reforma të pensioneve. Por, imlementimi i tyre ka pasur një ndryshim të dukshëm nga një shtet në tjetrin. Në disa shtete, është aprovuar dhe po implementohet legjislacioni i ri, si psh. në Hungari dhe në Poloni, ndërsa në shtet e tjera ende po debatohen reformat dhe rregullativat legale.

Ajo çfarë është e nevojshme për realizimin e një sistemi të qëndrueshëm pensional vlerësohet se është ndërtimi i një sistemi institucionesh financiare, të afta për të përmbushur detyrat mbi pensionet, duke kombinuar përvojat nga vendet tjera. Në shumicën e shteteve objektivat janë të përqëndruara në strukturimin e një kombinimi të sistemeve pensionale, duke përfshirë sektorin privat dhe sektorin publik.

4.2.Skema publike apo private e pensioneve

Edhe përkundër faktit se përkrahësit e rregullimit privat të pensioneve në shtetet në tranzicion ofrojnë argumente të shumëta për mundësitë dhe beneficionet që punëtorët kanë në sigurimin privat përkundrejt sigurimit publik, megjithatë shumica e kursimeve të pensioneve private investohen në asete publike. Në përgjithësi, gjatë periudhës së përë të tranzicionit në shtetet e Evropës Lindore, i është kushtuar një vëmendje relativisht e vogël zhvillimit të skemave private të pensioneve. Fillimisht fondet private të pensioneve zënin një vend më të rëndësishëm vetëm në Republikën Çeke dhe në Hungari. Në këto skema¹⁶ (në

¹⁶ Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike: Nga përvojat botërore në fushën e pensioneve, Tiranë 1997

vitin 1997) në Republikën Çeke ishin të përfshirë 1.125 mijë vetë, ndërsa në Hungari rreth 250.000 vetë.

Sidoqoftë, opcionet për investimin e mjeteve të pensioneve kanë qenë shumë të kufizuara. Pas hyrjes në fuqi të reformës mbi pensionet në Poloni në vitin 1999, 68% e kursimeve të punëtorëve ishin investuar në aksionet e thesarit, kurse 28 % në aksionet publike. Në Hungari tendenca për investim publik është edhe më e theksuar, përafërsisht 85% e fondeve janë investuar në letrat me vlerë të qeverisë, ndërsa 9% në letra me vlerë të korporatave. Po ashtu edhe përqëndrimi i kursimeve private në sigurime publike e jo private në vendet e Evropës Qëndrore dhe Lindore konsiderohet se momentalisht është strategjia më e arsyeshme, kur merret në konsiderim perspektiva e diversifikimit dhe madhësia e tregjeve financiare private dhe qëndrueshmëria mjaft e brishtë e tyre. Investimi në bonat e thesarit në këto vende ndihmon në promovimin e transparencës në fazat fillestare të reformës dhe gjithashtu mundëson financimin e tranzicionit, nga sistemi i vjetër PAYG, në sistemin e ri të fondeve.

Nuk ka ndonjë qasje unike në mes vendeve në tranzicion, sa u përket kontributeve për sigurimin social apo edhe elementeve të tjera të sistemit ose skemës pensionale.

Këto vende kanë zhvilluar politikat e tyre sociale në varshmëri nga kushtet ekonomike dhe veçoritë e tjera të cilat i kanë përcjelluar apo i përcjellin akoma në përpjekjet për t'u shkëputur nga sistemi i rregullimit shtetëror dhe për të kaluar në sistemin e rregullativës së tregut.

4.3.Sistemi i sigurimit social dhe pensional në vendet në tranzicion

Tabela 7: Disa indikatorë të sigurimit social dhe pensional në vende të ndryshme

Vendet	Shkalla e kontributit ¹⁷ (%)			Moshë e pensionimit			Niveli i pensionit në US\$	
	Totali	Punëtorët	Punëdhënsit	Meshkujt	Femrat	Vitet e kontributit	Minimumi	Maksimumi
Shqipëria	36	10	26	60	55	35	36	72
Armenia	31	3	28	62; 57; 52	57; 52; 47	25; 20; 15	5.4	7.6
Bullgaria	32	6.4	25.6	60.5	55.5	37.5; 32; 5	21.7	75.4
Kroacia	21.5	10.75	10.75	60.5	55.5	19.5	177	560
R. Çeke	26	6.5	19.5	60	55	25	70	
Estonia	20	0	20	62.5	57.5	15	30	S'ka
Kazakistani ¹⁸	26	1	25	60.5	55	25;20	27.6	60
Kirgistani	36	2	34	60	55	25;20	2.2	17.6
Letonia	32.58	9	23.58	60	57	10	51	S'ka
Lituania	24	1	23	62	60	30	19	S'ka
Rumania	28	5	23	60	55	30;25	24	S'ka

¹⁷ Kontributet mandatore për sigurimin social, me përjashtim të shëndetësisë dhe sigurimit të papunësisë.

¹⁸ Përfshinë 10% të kontributeve në shtyllën e financimit.

Rusia	29	1	28	60	55	25;20	5.2	15.6
Polonia ¹⁹	32.52	16.26	16.26	65	60	25;20	132	692
Repubilka Sllovake	27.5	5.9	21.6	60	53.57	25.20	93	189
Sllovenia ²⁰	24.35	15.5	8.85	65;63;58	60;58;53	15;20;40	... ²¹	... ²²
Kosova ²³	10	5	5	65	65			

Burimi: US Social Security Administration and IMF publications. Data refer to 1999, unless indicated otherwise përmes Wolker Treichel: Financial Sustainability Reform options for the Albanian Pension Fund, International Monetary Found,(internet) (Kosova është bashkangjitur për krahasim nga hartuesi i projektit)

Vendet në tranzicion i karakterizon niveli i ndryshëm, por i lartë i kontributeve për sigurimin social, ku përfshihen edhe kontributet për pensione. Në pikëpamje të lartësisë së kontributeve për sigurimin social veçohet Shqipëria me 36%(26% punëdhënësi dhe 10% punëtori), pastaj pasojnë, Letonia me 32,58% (23,58% punëdhënësi dhe 9% punëtori), Bullgaria me 32% (25,6% punëdhënësi dhe 6,4% punëtori) etj.

Mosha e daljes në pension në këto vende është kryesisht e njejtë²⁴. Numri më i madh i shteteve aplikojnë moshën e daljes në pension prej 60 vjeç. Mirëpo, kjo moshë oscilon deri në atë 65 vjeçare, e cila aplikohet në Slloveni dhe Poloni. Mosha 65 vjeçare parashihet të aplikohet edhe në Kosovë. Aplikimi i moshës më të re të daljes në pension në shumë vende imponohet nga presioni për punësimin e popullësisë së re aktive për punë (shih shtojcën: Mosha e daljes në pension).

Karakteristikë e shumë vendeve në tranzicion është një nivel mjaft i ulët i pensioneve në raport me pagat. Në tabelën vijuese është prezantuar mesatarja e pensioneve. Duke krahasuar me vendet e tjera, në Kosovë është propozuar një nivel bazë i pensioneve duke lënë anash këta indikatorë.

¹⁹ Përfshinë 7.3% të kontributeve në shtyllën e financimit.

²⁰ Norma mesatare e kontributeve.

²¹ Mesatarja e të ardhurave për 35% të mashkujve dhe 40% e femrave për 10 vite në intervalin nga viti 1970

²² Maksimumi i beneficioneve nga shoqëria e sigurimit është 85%.

²³ Dokumenti i UNMIK-ut: Draft Regulation on Pensions envisages 10% contribution to the funded pillar.

²⁴ Wo16lker Treichel: "Financial Sustainability Reform options for the Albanian Pension Fund, International Monetary Found", (internet).

Tabela 8: Pjesëmarrja e pensioneve në paga

Nr	Vendi	Viti	Pjesëmarrja e pensioneve mesatare në pagat mesatare	Pjesëmarrja e pensioneve minimale në pagat mesatare
1	Shqipëria	1999	-	30
2	Armenia	1996	24.0	3,4
3	Azerbejxhani	1996	29.0	-
4	Bellorusia	1995	43.0	-
5	Bullgaria	1995	31.0	18.4
6	Kroacia	1997	48,7	34,6
7	Rep. Çeke	1996	48.6	21,8
8	Estonia	1995	25.0	10
9	Gjeorgjia	1996	36.0	-
10	Hungaria	1996	57.0	-
11	Kazakistani	1996	31.0	12,1
12	Letonia	1994	62.8	19
13	Maqedonia	1996	63.5	-
14	Polonia	1995	55.4	33,9
15	Rumania	1994	43.1	19,2
16	Slllovakia	1994	42.5	62,8
17	Slllovenia	1996	68.6	-
18	Ukraina	1995	32.0	-
19	Kosova	2002	10.0	10

Burimi: Robert Palacias and Monserrat Pallares-Millares: International Patterns of Pension Provision, World Bank, April 2000. Vërejtje: Kosova është bashkëngjitur nga Riinvesti, për qëllime krahasimi.

Një kontribut të rëndësishëm në reformimin e sistemit pensional në shtetet në tranzicion kanë dhënë Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Banka Botërore është angazhuar në reformat e sistemit pensional, ka ndihmuar rreth definimit të politikës drejtuese dhe aktiviteteve të ardhshme në këtë fushë. Stafi i Bankës Botërore është angazhuar në reformat e sistemit pensional, të punuar në 30 vende, kryesisht nëpërmes dhënies hua dhe asistencës teknike.

Banka Botërore përkrah qasjen shumë shtyllore. *Shtylla e parë*, financuar nga tatimi në të ardhura ose të ardhurat e përgjithshme të fokusuar në redistribuim. *Shtylla e dytë* është sistem financiar, ku kontributet e detyrueshme individuale akumulohen në formë kursimi dhe investohen për pagimin e pensioneve të tyre në të ardhmën. Pra pensionet e detyruara duhet të jenë të mjaftueshme për të siguruar ngritjen e shtyllës së tretë. *Shtylla e tretë*, kursimi vullnetar, iu lejon individëve që vetë të zgjedhin si të bëjnë alokimin e të ardhurave të tyre gjatë jetës së tyre

**4.4. Çështjet e
pazgjidhura në
reformën pensionale në
vendet në tranzicion**

Çështjet e pazgjidhura në reformën pensionale vlerësohen se janë të mëdha. Ato kanë të bëjnë me:

- Mënyrat e kthimit të kursimeve të akumuluar të punëtorit në pension në kohën e pensionimit si dhe shpenzimet përcjellëse (a do të jenë disa kompani garantuese pensionale apo një kompani garantuese pensionale);
- A do të merret parasysh mosha mesatare e meshkujve dhe e femrave gjatë llogaritjes së pensioneve (se femrat punëtore kanë qenë të dëmtuara me një anë me ngritjen e moshës së pensionimit).
- Si do të ristrukturohën beneficionet pensionale;
- Taksat e larta si dhe dobësia organizative e shërbimeve tatimore , krijojnë nxitje të forta që të lëvizin drejtë ekonomisë ilegale (rritja e punësimit joformal).;
- Dialogu shoqëror mbi reformën e pensionit është kufizuar në shumicën e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, dhe miratimi trepalësh nga sindikatat, ekspertët dhe qeveria nuk është arritur shpesh. Kjo është si rezultat mungesës së traditës për të arritur koncesus shoqëror.

**5.DISA RELACIONE
MAKROEKONOMIKE
TË SISTEMIT
PENSIONAL**

Efektet e skemës së propozuar në sfondin makroekonomik të Kosovës mund të vështrohen nga aspekti i ndikimeve që mund të ketë në GDP konsumi Buxhetor dhe përgjithësisht politika fiskale, përkatësisht në faktin se sa buxheti i Kosovës në një periudhë afatgjatë do të jetë i rënduar me nevojën e pagesës së pensioneve bazë, si dhe nga aspekti i ndikimeve pozitive që mund të ketë kjo skemë në gjenerimin e investimeve të reja.

Është evidente se pjesëmarrja e pensionit bazë në Buxhetin e Kosovës do të ketë një peshë të rëndësishme specifike dhe se do të ndikojë në ristrukturimin e tij. Ndonse lartësia e pensionve që do të gjenerohen nga kjo shtyllë është mjaftë modeste, prapë se prapë në kushtet e dhëna dhe mundësitë e kufizuara buxhetore do të jetë vështirë të gjendet hapsirë për përmirësimin e tyre, gjë që paraqet një problem për pensionistët aktualë dhe ata që do të pensionohen gjatë 10-15 viteve të ardhshme, meqenëse pensioni suplementar nga fondi i kursimeve nuk do të ndikojë aq tepër në rritjen e tyre.

Ngritja e nivelit të pensioneve është e lidhur drejtpërsëdrejti me nivelin e përgjithshëm të buxhetit. Pjesëmarrja e fondit të pensioneve në buxhetin e Kosovës do të jetë rreth 9% në vitin 2002 dhe prej vitit 2004 do të stabilizohet në rreth 20%. Përjashtim këtu mund të bënë vetëm ajo pjesë e cila do të sigurohet nga fondet e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Tabela 9: Aspektet makroekonomike të sistemit pensional (Vlerat në 000 DM)

	Periudha -viti				
	2000	2001	2002	2003	2004
GDP ²⁵	3000000	3700000	4300000	4700000	5200000
Indeksi i GDP	100	123	114.00	110.00	111.00
Të hyrat e buxhetit	235000	538000	681000	792000	895000
Indeksi i buxhetit	100	229	127	116	113
Buxheti/GDP	7.8	14.8	17.0	18.6	18.5
Pagat ²⁶	1,546,000	1731520	1904672	2057046	2201039
Fermerët ²⁷	13,500	15120	16632	15600	16692
Indeksi i pagave	100	112	110	108	107
Nr. i pensionistëve ²⁸	130000	131548	135718	140086	144429
Shuma e pens. mujor			40/55 ^a	40/55 ^b	55
Pensioni bazë ²⁹			34500/74600 ^a	67200/92400 ^b	95300
Pensions/GDP			0.8/1.7 ^a	1.4/2.0 ^b	1.8
Pensions/bxhet			5.1/11.0	8.5/11.7	10.7
Fondi i kursimit të pensioneve ³⁰			35154	156661	287095

Burimi: Vlerësimet e Riinvest, bazuar në të dhënat e AQF-së, Bankës Botërore dhe FMN-së.

a) Dy alternativa, scenario, të supozuara: pensioni në nivel prej 40 DM duke filluar nga data 1 mars 2002, duke përfshirë të moshuarit mbi 70 vjeç dhe duke filluar nga data 1 tetor 2002 duke përfshirë të moshuarit nga 65 deri 69 vjeç. Alalternativa e pagesës së pensioneve për të gjithë të moshuarit mbi moshën 65 vjeç, duke filluar nga data 1 mars 2002.

²⁵ Bruto Produkti Vendor (GDP) në vitin 2000 është vlerësuar nga FMN-ja përafërsisht 3 miliard DM, ose 1.580 DM për kokë banori (per capita), duke pasur parasysh vlerësimin e numrit të popullsisë prej 1,9 milion banorëve.

²⁶ Janë marrë parasysh 308.000 persona të punësuar, (sipas vlerësimeve të institutit Riinvest), 135.000 të punësuar në ndërmarrjet private, 50.000 në ndërmarrjet shoqërore, 48.000 në shërbimet tjera dhe 75.000 në shërbimet publike, si dhe paga mesatare sipas lëmime. Niveli mesatar i pagave është përcaktuar në bazë të rezultateve nga anketat e Institutit Riinvest, dhe të dhënat nga Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale të Kosovës.

²⁷ Një numër i fermerëve prej 90.000 sish është marrë si i supozuar, pasi që kontributet e tyre për fondin e pensioneve do të bazohen në pagat minimale prej 150 DM.

²⁸ Numri i pensionistëve dhe rritja vjetore është bazuar në të dhënat e UNMIK-ut.

²⁹ Pensionet bazë janë vlerësuar duke marrë për bazë numrin e pensionistëve sipas të dhënave në tabelë. Për vitin 2002, është supozuar se pensionistët e moshës mbi 70 vjeç do të fillojnë të marrin pensione në Mars, ndërsa ata të cilët e kanë moshën ndërmjet 65 dhe 69 do të fillojnë të marrin pensionet në Tetor të vitit 2002.

³⁰ Sipas vlerësimeve të AQF-së për vitin 2002 dhe 2003. Vlerësimet për vitin 2004 janë të Institutit Riinvest. Vlerësimi me 3% kamatë reale; shkalla e inflacionit prej 8% në vitin 2002, prej 6% në vitin 2003 dhe prej 5% në vitin 2004.

b) Dy alternativa të supozuara me dy nivele mujore të pagesës së pensioneve 40DM dhe 55 DM.

Niveli i tanishëm i lartësisë së pensioneve është në shpërputhje me shportën e cila siguron minimumin e kalorive për një të rritur, të deklaruar nga Banka Botërore dhe ILO. Prandaj në funksion të përmirësimit të nivelit të pensioneve është udhëheqja e një politike tatimore dhe doganore e cila, përmes zgjerimit të bazës tatimore, do të siguronte një përfshirje sa më të madhe të të gjithë obliguesve tatimorë, duke shkarkuar kështu bizneset nga pesha akoma shumë e lartë specifike e tatimeve dhe taksave, dhe duke siguruar një pjesëmarrje sa më të barabartë të obliguesve tatimorë në përmbushjen e këtyre obligimeve.

Mungesa e të dhënave statistikore për kategoritë elementare makroekonomike e vështirëson një prognozë më të përafërt, megjithatë në bazë të disa vlerësimeve nga AQF, Banka Botërore dhe studimet tona mund të bëhet një simulim i relacioneve themelore midis: Ecurisë së GDP-së, buxhetit, fondeve të pensioneve dhe efekteve të pritura të këtyre fondeve jo vetëm në konsumin buxhetor, por edhe në zhvillimin e tregut financiar në Kosovë dhe nxitjen e aktiviteteve inventive.

Rritja e beneficioneve të pensioneve në para të gatshme në zonat jo mjaft të zhvilluara dhe të demonetizuara do të ketë një rol të rëndësishëm makroekonomik. Familjarët e varfër do t'i shfrytëzojnë paratë e tyre për blerjen e produkteve dhe shërbimeve vendore, që do të reflektohet pozitivisht në kërkesën për produktet vendore të prodhuesve vendorë dhe në këtë mënyrë kjo do të ndikojë edhe në një aspekt tjetër të zhvillimit.

Fondet e akumluara sipas shtyllës do të sigurojnë burime potenciale për financimin e zhvillimit të Kosovës në të ardhmen, kur procesi i privatizimit krijon mundësinë për investime vendore. Këto investime do t'i plotësojnë të gjitha standardet e sigurisë dhe transparencës.

Tabela 10: Pjesëmarrja e pensioneve në GDP në disa vende

VENDET	Popullsia 60+/popullsia 20- 59	Viti	Pjesëmarrja e pensioneve në GDP në vit
SHBA	29	1995	5.36
Gjermania	35.7	1995	10.29
Suedia	41	1995	8.17
Kosova ³¹	6,0	2002	0.8
Shqipëria	18,5	1995	5.1
Polonia	29.4	1995	15.0
Hungaria	35.7	1996	10.3
Izraeli	12.1	1996	5.9

³¹ Pjesa buxhetore dhe kursimet pensionale, të parapara për vitin 2002.

Algjeria	13.0	1997	2.1
Çile	17.5	1993	5.8
Bolivia	16.2	1995	2.5
Benini	11.5	1997	0.4
Nigeria	10.2	1991	0.1
Kina	17.2	1996	2.7
Vietnami	16.1	1998	1.6

Burimi: FMN dhe AQF

Siç shifet nga kjo tabelë, pjesëmarrja e pensioneve në GDP në vendet e zhvilluara dhe ato në tranzicion është e ndryshme. Me pjesëmarrje më të ulët dallohen vendet e Amerikës Latine me Karibet, të Afrikës dhe ato të Azisë me Pacifikun.

Në vendet e OECD³², gjatë vitit 1995 dhe 1996 pjesëmarrja e shpenzimeve për pensione në GDP është sjellur nga 15% në Itali, në Austri 14,9, në Francë 13,3, në Luxemburg 12,6%, në Zvicër 7,2%, në Japoni 6,6%, në Kanada 5.4, dhe në Australi 4.6% etj.

Në Kosovë pjesëmarrja e pensioneve në GDP pritet të sillet rreth 3,5% gjatë dekadës në vijim, gjë që bie në radhën e vendeve me ngarkesë më të ulët të GDP-së me pensione. Në këto rrethana Kosova, po ashtu, do të cilësohet edhe me pjesëmarrje të ulët të pensioneve në paga.

Fondi i kursimeve pensionale, i cili synon të kapitalizohet nëpërmjet investimeve, paraqet një moment me rëndësi në sistemin ekonomik financiar të Kosovës. Efektet e këtij fondi në lartësinë e përgjithshme të pensioneve, por edhe në aktivitetet investues në vitet e para deri më 2004 do të jenë modeste, por me kohë do të rriten dhe bashkë me fondin e kontributeve vullnetare, mund të bëjnë përmirësim të ndieshëm në këto dy aspekte.

Skema e re e pensioneve kërkon zgjerimin e kapaciteteve manaxheriale të administruesve të pensioneve (administratës së pensioneve në Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Trustin e Pensioneve, BPK, Banka, etj.) Krijimi i kësaj strukture administrative dhe manaxheriale duhet të bëhet nga fillimi. Punëtorët e ish administratës së pensioneve brenda Fondit të Sigurimeve pensionale, të cilët ende janë të involvuar në problemet e pensionistëve mundën vetëm pjesërisht të ballafaqohen me kërkesat e skemës së re. Ndërtimi i kësaj administrate do të ballafaqohet që nga fillimi me nevojën e një kombinimi optimal të asistencës ndërkombëtare dhe punëtorëve lokalë dhe transferin gradual të këtyre obligimeve tek punëtorët lokalë. Kjo do të shtojë nevojën për një program gjithpërfshirës të ndërtimit të kapaciteteve vendase.

6.SFIDAT E MANAXHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË PENSIONEVE

³² Robert Palacios and Montserrat Palleres-Mirallas: INTERNATIONAL PATTERNS OF PENSION PROVISION, April 2000

Ekzistojnë një numër i vështirësive manaxheriale, administrative dhe të infrastruktures të cilat do t'i kufizojnë potencialet për zhvillimin efikas dhe administrimin e sistemit të sigurimit social në Kosovë. Ekziston nevoja për presion ndaj ngritjes së theksuar të kapaciteteve manaxheriale dhe administrative kosovare në sferën e sigurimit social (dhe ndoshta edhe në sektorin publik në përgjithësi).

Aftësitë manaxheriale kyçe përfshijnë: planifikimin strategjik të biznesit, menaxhmentin e përgjithshëm, menaxhmentin e projekteve, menaxhmentin financiar dhe të resurseve humane. Aftësitë duhet të plotësohen me një angazhim aktiv në sigurinë sociale ndërkombëtare dhe kjo do të mundësojë qasjen në trendet moderne të mendimit mbi sigurinë sociale. Aftësitë administrative, të shoqëruara me teknologjinë administrative moderne, kërkojnë perfeksionim. Këto aftësi përfshijnë: shfrytëzimin e teknologjisë informative dhe të komunikimit, shërbimet ndaj klientëve, marrja përsipër e përgjegjësive individuale, orarin e punës dhe trajnimin e ekipeve.

Gjendja aktuale e infrastrukturës së komunikimit gjithashtu do ta kufizojë punën e administratës dhe do t'i rritë shpenzimet për implementimin e programeve të sigurimit social. Për shembull, një sistem i adresave postare me gabime do të thotë se komunikimi me klientët e mirëqenies sociale do të jetë i vështirësuar. Pastaj, mungesa e kapaciteteve në rrejtin postar (dhe problemet aktuale të sigurisë me rastin e bartjes dhe ruajtjes së parave të gatshme) do të thotë se opsionet për shpërndarjen e beneficioneve janë të kufizuara. Zhvillimi afat-shkurtë dhe afat-mesëm i sistemit të teknologjisë informative dhe të komunikimeve i cili do t'i lidhte qendrat lokale në një shtab, do të vështirësohet shumë nga kapaciteti i sistemit të tanishëm të komunikimeve.

ANEKSI I

Aleksandra Naceva¹

REFORMA E SISTEMIT PENSIONAL TË IRJM-së

Fondi i pensioneve private në të ardhëmen do të dominojë dhe do të jetë "faktori kryesor" në tregun e kapitalit në IRJM. Si bartës kryesor i sigurimit pensional, ai do t'i sigurojë qytetarëve një kanal të sigurtë dhe dobiprurës për investimin e kursimeve të tyre, ndërsa si investitor institucional ai do të "gjallërojë" tregun e kapitalit në vend.

Sikur shumë ekonomi të tjera nacionale në Evropë, IRMJ-ja është në gjysmën e rrugës të transformimit demografik, transformim i cili do të rezultojë me një ngritje drastike të popullësisë së moshuar në raport me popullësinë e aftë për punë (aktive). Ky proporcion, shpesh i referohet "shkallës së varësisë" e cila tani është 25%, por pritet një ngritje e shpejtë deri në 35% në vitin 2020, 50% deri në 2050 dhe ndoshta edhe 60% në 2060³³.

Popullsia është duke u mplakur dhe do të ketë një ndikim të rëndësishëm në sistemin e detyrueshëm pensional të vendit, i cili do të financohet, nga i ashtuquajtimi, pay – as – you – go (PAYGO). Në sistemin PAYGO, kontributet sigurohen nga të siguruarit në sistem, të cilat transferohen menjëherë për pagesën e pensioneve të pensionistët. Ky system lehtë financohet kur proporcionet e pensionistëve të siguruar përmbillen, kurse problemet e financimit paraqiten atëherë kur ka hendek në proporcione. Ndryshimet demografike (të shkatuara nga shkalla e ulët e lindjeve dhe nga kohëzgjatja e jetës së popullësisë), po ashtu edhe shkalla e lartë e papunësisë do të ndikojnë në rritjen proporcioneve të pensionerve në raport me të siguruarit në IRMJ-së, e cila do ta intensifikonte shtypjen në sistemin fiskal (në të hyrat e domosdoshme të buxhetit për mbulimin deficitit pensional, i cili vazhdimisht do të rritet). Është tipike për qeveritë që të reagojnë në rritjen e presionit mbi sistemin fiskal, duke ngritur shkallën e kontributeve, duke ngritur kufirin e moshës për pensionim si dhe duke ulur normën e zëvendësimit³⁴. Këto ndryshime ndihmojnë në uljen e presionit fiskal, monetalisht keto masa e bëjnë më pak atraktiv për pjesëmarrsit e tyre dhe e rritin mundësinë që të punësuarit të ndërmarrin aktivitete në sektorin joformal (që t'u shmangen pagesës së kontributeve dhe taksave shoqërore). Kështu që reformat në pension ngushtojnë kushtet e ekzistimit të sistemit PAYGO, sistem që nuk është zgjidhje e mirë.

³³ Burimi i infomatës: Raporti zyrtar për vitin 2000, Njësia aktuale në Fondin për pension dhe sigurim invalidor të IRJM-së

³⁴ " Niveli i zëvendësimit" është definuar si përqindje e përcaktimit të pensionit nga baza e pensioneve.

Shumë qeveri më sistem PAYGO kanë krijuar zgjidhje me adekuate për të adresuar ndryshimet demografike. Në vend se të bëhet një kufizim strikt i sistemit PAYGO, këto shtete³⁵ kanë ndryshuar strukturën e sistemit të pensionit nga mënyra e orientimit të tyre në financimin PAYGO në financimin kapital (apo në kombinimin e të dy metodave të financimit). Me gjithë sistemin PAYGO, financimi kapital është sistem relativisht imun kundrejtë ndryshimeve të natyrës demografike. Në sistemin kapital, kontributet e të çdo të sigurari janë të depozituara në llogari individuale të investimeve, në vend që transferohen për pagesë të pensionistëve aktualë.

Fondet nga llogaritë individuale mund të investohen në depozitat e bankës, bonat e qeverisë, aksione dhe në instrument të tjerë financiarë³⁶. Deri sa punëtorët të arrijnë kohën për pensionim, këto fonde transformohen në anuitete nëpërmjet të cilave është bërë pagesa e pensioneve. Kështu që, çdo i punësuar e bënë financimin e pensionit të tij dhe se ky kontribut nuk bartet në gjenerata të reja. Si rezultat i zotërimit të llogarive individuale, sistemi i financimit kapital është shumë më pak i rrezikuar nga ndryshimet demografike, se që është sistemi PAYGO. Është madje shumë e rëndësishme që sistemi i financimit të kapitalit promovon zhvillimin e tregut të kapitalit dhe me këtë rrit normën potenciale të ekonomisë kombëtare.

Pasi që sistemi i kapitalit është imun ndaj rrezikut demografik, në anën tjetër ai i është ekspozuar rrezikut investiv. Tregjet e kapitalit po ballafaqohen me periudha ku fitimet janë të vogla, por edhe me lëvizje ciklike të këtyre fitimeve. Megjithëse këto rreziqe mund të ulen nëpërmes obligimit ligjor të fondeve të pensioneve për të mbajtur portofoliot e diversifikuara të investimeve, dhe nëpërmes ndalimit të investimeve në asete me risk të lartë, edhe pse rrishti i investimeve nuk mund të eliminohet në tërësi. Eliminimi i tërë rrezikut është madje i padëshiruar, pasi që rreziku është karakteristikë e tregjeve të kapitalit duke i motivuar investitorët të marrin vendime të mençura dhe ta derjtojnë kapitalin kah projektet dhe investimet më profitabile.

Duke marrë parasysh të gjitha përparësitë dhe të metat e opsioneve të ndryshme të reformës, Qeveria e IRJM-së ka përgatitur në mars të vitit 2000 Ligjin mbi Modifikimet dhe Amandamentet e Pensioneve dhe Ligjin e Pamundësisë së Sigurimit. Me këtë është përcaktuar se opcion më i përshtatshëm i reformimit që hecën kah zëvendësimi gradual i sistemit PAYGO me sistemin e “tri shtyllave”. Sistemi tre shtyllorë do të përmbajë:

- Shtyllën e parë – e detyrueshme, e financuar në baza PAYGO, nëpërmes të cilës do të arrihet solidariteti në mes brezave,

³⁵ Shtetet që tanimë kanë futur në përdorim shtyllën e financimit kapital janë Hungaria, Polonia, Kili, Argentina, Bolivia, etj.

³⁶ Në Ligjin mbi Sigurimin e Pensioneve të Financuara me Kapital (Ligji është në procedurë parlamentare) 14 instrumentet financiare janë përcaktuar në të cilat fondet mund të investohen nga siguresit e sistemit të ri pensional.

- Shtylla e dytë – e detyrueshme, e financuar në bazë të kapitalit dhe
- Shtylla e tretë – vullnetare, e financuar në bazë të kapitalit.

Dy të fundit janë për të ofruar siguri materiale. Me këtë participantët në sistemin e ri të pensioneve (pjesa e obligueshme) do t'i kenë dy “këmbë” për të qëndruar , kështuqë, nëse njëra prej tyre dobësohet me kohën, tjetra do të vazhdojë të mbështes pensionet. Pra, risqet e sistemit do të jenë të balancuara mirë në mes të rrezikut demografik dhe rrezikut investiv.

Ajo çka pason është një prezantim i sistemit ekzistues të pensioneve, i sistemit të ri “ të detyrueshem dy – shtyllësh”, sikurse edhe një plan për kalim nga sistemi ekzistues kah ai i ri reformuar.

Në bazë të indikatorëve themelorë, të përfaqësuar në tryezë, i punësuar duke qenë i siguruar i sistemit një shtyllësh pensional, paguan 20% normë të kontributit në PAYGO sistem dhe nxjerr rreth 72% - 80% normë të zëvendësimit kur të pensionohet (duke përfshirë vitet complete të shërbimit, rreth 35 – 40 vjet). I siguruari i sistemit të shtyllës së dytë paguan 13% normë të kontributit në sistemin PAYGO, dhe 7% normë të kontributit në shtyllën e dytë që pastaj, direkt i referohet llogarisë individuale të të siguruarit.

I siguruari, pas pensionimit, fiton rreth 30% normë zëvendësimi nga sistemi PAYGO, pasi që pensioni gjeneron përmes kthimit të kursimeve të akumuluarra të sistemit të shtyllës së dytë të sigurimit në anuitete. Duke u mbështetur në llogaritje konzervative, duke pasë parasysh lëvizjen e normave të kamatës, shtylla e dytë do të jetë e mjaftueshme për të gjeneruar një normë të zëvendësimit për rreth 40%-50%, përderisa norma totale e zëvendësimit do të silltet rreth 70%-80% (30% nga e para dhe 40%-50% të shtyllës së dytë).

<i>Treguesit themelor</i>	Sistemi ekzistues	Sistemi dy-shtyllësh
Mosha e pensionimit, mashkuj	64	64
Mosha e pensionimit, femra	Gradualisht rritet në 62	62
Norma e kontributit, shtylla 1 (PAYGO)	20%	13%
Norma e kontributit, shtylla 2 (e financuar me kapital)	0%	7%
Norma totale e kontributit	20%	20%
Norma e projek. e zëvendësimit, shtylla 1	72%-80%	30%
Norma e projekt. e zëvendësimit, shtylla 2	0%	40%-50%
Norma totale e projektuar e zëvendësimit	72%-80%	70%-80%

Shënim:

1. Norma e zëvendësimit është shprehur si një përqindje e pagës neto, përdrisa norma e kontributit si një përqindje e pagës brutto.
2. Norma e zëvendësimit e paraqitur në tabelë është llogaritur për një të punësuar që do të shpenzoj të gjitha vitet e tij të shërbimit pas 2003.
3. Norma e zëvendësimit në shtyllën e dytë është llogaritur duke marrë që normat e fitimit të tregut janë mbi 2% të rritjes së pagave.

***Kalimi nga sistemi
një-shtyllësh i
pensioneve në atë
dy-shtyllësh***

Kalimi kah sistemi dy-shtyllësh do të kryhet gradualisht në kohën prej 50 vjetësh, gjatë të cilës kohë, sistemi ekzistues një-shtyllësh dhe sistemi i ri dy-shtyllësh do të bashkeekzistojnë. Kalimi do të fillojë më 2003, kur të gjithë pëntorëve do t'iu jepet opcioni i hyrjes së sistemit të ri. Duke patur parasysh që sistemi kërkon nga të punësuarit që të heqin dorë nga shumica e të drejtave të trashëguara, pritët që vetëm të siguruarit e rinj nën moshën 35 vjeçare do të kalojnë në sistemin e ri. Siguruesit e vjetër më gjasë do të rrijnë në sistemin e ekzistues një – shtyllësh. Me kohë, një rritje e fuqisë punëtore, do të përfshihet në sistemin dy- shtyllësh, posaçërisht, pasiqë pjesmarrja në sistemin e ri të të punësuarve të rinj është parashikuar si e detyrueshme. Pas përafërsisht 25 vjetësh, praktikisht tërë fuqia punëtore do të sigurohet në sistemin e ri dhe do të vij deri të derdhja e parë e pensionerve nga sistemi dy-shtyllësh. Gradualisht, në mes viteve 25-ta dhe 50-ta të reformës, struktura e pensionistëve do të ndryshojë nga 100% në një-shtyllësh, në 50% në secilën prej dy shtyllave duke përfunduar në 100% pensionistë në sistemin e ri. Gjatë 50 vjeteve të reformës, tranzicioni pritët të përfundojë, prandaj të gjithë të siguruarit dhe pensionistët do të jenë në sistemin e ri.

Gjatë periudhës së tranzicionit, Qeveria do të përballet me detyrën e financimit të pensionistëve nga sistemi një-shtyllësh, por pa pasur qasje në normën ekzistuese të kontributit prej 20%. Pasiqë, çdo i siguruar në sistemin dy-shtyllësh do të paguajë 7% normë të kontributit në llogarinë individuale të shtyllës së dytë, vetëm 13% e norms së kontributit do të mbetet për të financuar sistemin PAYGO. Kështu pra, pasiqë fuqia punëtore lëviz nga sistemi një shtyllësh në sistemin dy- shtyllësh, norma mesatare e kontributit në sistemin PAYGO do të bie nga 20% në 13%. Kjo renie do të ndodhë në gjysmën e parë të tranzicionit, në mes të vitit të parë dhe të 25-të të tranzicionit. Në gjysmën e dytë, nga viti i 25-të në vitin e 50-të të reformës, norma mesatare e zëvendësimit në PAYGO do të bie në të njëjtën mënyrë, në të cilën bie norma mesatare e kontributit në gjysmën e parë të reformës. Gradualisht, norma mesatare e zëvendësimit në PAYGO për një të siguruar në të gjitha vitet e shërbimit duke marrë pjesë në sistemin dy- shtyllësh, do të bie nga 72% në 30%. Si pasojë, gjatë gjysmës së parë të reformës, sistemi PAYGO do të ngritet kundrejt presionit fiskal (deficit) si rezultat i rënies në normën mesatare të kontributit, por në gjysmën e dytë të reformës ky presion do të ulet si rezultat i

rënies së normës mesatare të zëvendësimit të shtyllës së pare, pasiqë reforma arrin një periudhë më të pjekur.

Simulimet aktuale tregojnë për projektimet që tranzicioni do të jetë relativisht i lehtë duke kërkuar finacime relativisht modeste nëpërmes huasë publike apo nëpërmes Buxhetit Qendror. Një rritje e moderuar ekonomike, e kombinuar me kushte të shtrënguara në sistemin PAYGO, sikurse limiti i rritur i moshës, janë parakushte të mjaftueshme për tranzicion relativisht të lehtë dhe të suksesshëm, pa ndonjë problem të madh financiar.

Shumë vende e kanë ndryshuar nënstrukturën e sistemit të pensioneve duke u ridrejtuar, nga sistemi i financimit PAYGO, në financimin me kapital (apo kombinim i dy metodave të financimit). Ndryshe nga sistemi PAYGO, sistemi i financimit me kapital është relativisht imun ndaj ndryshimeve të natyrës demografike.

Tranzicioni i lehtë i sistemit është kryesisht për shkak të papjekurisë së sistemit PAYGO të pensioneve në IRJM, që shtë shumë evident kur ta krahasojmë këtë sistem, për shembull me atë në Slloveni. Të dyja vendet kanë një popullsi prej rreth 2 milionë, por sistemi i pensioneve në IRJM ka mezi 235 mijë pensionistë, përdërisa ai slloven ka rreth 460 mijë, që është gati sa dyfishi i numrit të pensionistëve në vendin tonë. Si rezultat, IRJM do të bart një barrë më të vogël të pensionistëve gjatë kalimit në sistemin e ri dy-shtyllësh të pensioneve.

Si pasojë, gjatë gjysmës së parë të reformës, sistemi PAYGO do të ngritet kundrejt presionit fiskal (deficit) si rezultat i rënies në normën mesatare të kontributit, por në gjysmën e dytë të reformës ky presion do të ulet si rezultat i rënies së normës mesatare të zëvendësimit të shtyllës së pare, pasiqë reforma arrin një periudhë më të pjekur.

Çdo i siguruar në sistemin dy-shtyllësh do të ketë llogarine e vet personale investive. Këto llogari do të drejtohen nga kompani private për menaxhimin e fondeve të pensioneve duke qenë subject i revizionimit nga Agjencia përgjegjëse për ofrimin e sigurisë për fondet e sigurveve të shtyllës së dytë.

Çdo i siguruar do të ketë të derjtën për të transferuar fondet e tij nga një kompani, në kompaninë tjetër për menaxhimin e fondeve të pensioneve (nëse i siguruari është i pakënaqur me punën e kompanisë për manaxhimin e fondeve të pensioneve).

Me qëllim të menaxhimit të fondeve të të siguruarit, çdo kompani për menaxhimin e fondeve të pensioneve do të marrë përqindje (të përcaktuar si një përqindje të kontributeve të të siguruarit). Çdo kompani do të ketë të drejtën që individualisht të identifikojë përqindjen e provizionit të mbledhur. Pasiqë shumë kompani do të konkurrojnë njëra me tjetrën në treg për menaxhimin e fondeve të të siguruarëve, do të ketë faktorë të mjaftueshëm motivimi për t'i mbajtur provizionet në një nivel relativisht të ultë.

Struktura e shtyllës së dytë

Në fillim, vetëm dy kompani për menaxhimin e fondeve do të jenë në gjendje për të nxjerrë autorizimin për menaxhimin e kontributeve të shtyllës së dytë. Duke limituar numrin e kompanive në treg, Qeveria mundohet që të tërheqë kompanitë e mëdha të njohura të marrin pjesë në tregun e sigurimit të pensioneve.³⁷

Projektimet rreth drejtimit të shtyllës së dytë

Në fazat initiale të reformës, kontributet që derdhen në shtyllën e dytë janë vlerësuar në 1% të GDP-së (rreth 30 milionë dollarë amerikan). Pasi të konsolidohet shtylla e dytë, hyrja e kontributeve gradualisht do të akumulohet dhe do të arrijë 2.5% të GDP-së në nivelin vjetor. Fondet në dispozicion të shtyllës së dytë gradualisht do të rriten në 10% të GDP-së kah viti 2010. Më 2020, fondet në shtyllën e dytë janë projektuar që të ngriten në 1 miliard dollarë amerikan (vlera reale), përderisa duke shikuar në afat të gjatë, fondet do të vijnë në një qetësim për rreth 100% të GDP-së.

Tabela: -- Shtylla e dytë e pensioneve në IRJM

	2003	2005	2010	2020	2030	2040	2050
Të siguruarit në shtyllën e dytë (në 000)	120	141	245	448	586	588	564
Kontributet në shtyllën e dytë (% GDP)	0.7%	0.8%	1.3%	2.1%	2.6%	2.7%	2.7%
Fondet në shtyllën e dytë (% GDP)	0.7%	2.2%	7.5%	24.7%	50.5%	78.3%	95.7%
Kontributet në shtyllën e dytë (në US\$ milion)	21	25	48	104	173	241	325
Fondet në shtyllën e dytë (në US\$ milion)	21	70	276	1124	3365	7012	11518

Përvetësimet:

1. Rritja reale e GDP-së = 3% në vit
2. Normat reale të fitimit në shtyllën e dytë = 5% në vit

Të dhënat në tabelë tregojnë për faktin se fondet private të pensioneve me kohë do të bëhen "lojtarë" dominant në tregun maqedon të kapitalit. Si bartës të sigurimit të obligueshëm të pensioneve, ata do të furnizojnë qytetarët me një kanal të sigurtë dhe fitimprurës të investimit të kursimeve të tyre, përderisa si investitorë institucionale ata do të "lëvizin" tregun e kapitalit në vend. Me anë të futjes së vlerave substanciale në ekonomi, ata do të inkurajojnë sektorin privat dhe do ta rrisin vlerën e ekonomisë kombëtare, sikurse edhe potencialin e këtij vendi për rritje ekonomike dhe zhvillim.

³⁷ Nëse një numër i konsiderueshëm i kompanive fillimisht janë autorizuar që të marrin pjesë në treg, pjesmarrja në treg e secilës kompani do të jetë minimale, përderisa kompanitë e mëdha nuk do të jenë të motivuara të hyjnë në treg.

Dr. Jože Zagožen

PENSIONI DHE INVALIDITETI NË SLLOVENI

1. Në Slloveni është në përdorim sistemi i njëjtë me atë të vendeve të tjera nga ish- Jugosllavia. Ky system ka të bëjë me sistemin »pay as you go.

Kjo do të thotë se gjatë muajit, duhet të sigurohen aq kontribute sa komunitetet e sigurimit pensional dhe invalidor kërkojnë në fund të muajit. Të drejtat për personat e siguar janë të përcaktuara në mënyrë fikse, megjithatë kontributet duhet të përshtaten. Duhet të ketë gjithmonë aq kontribute sa të drejta të përcaktuara. Për këtë ne duhet të grumbullojmë para, për aq njerëz sa janë të emëruar për atë pension apo invaliditet.

Kushti kryesor për suksesin e këtij sistemi është proporcioni i drejtë në mes numrit të personave të siguar dhe numrit të pensionistëve, të cilët jetojnë sipas këtij sistemi. Nëse ky proporcion është i ngjshëm si proporcion në mes periudhës aktive dhe periudhës pasive, atëherë arrihen rregullësi në funksionimin e këtij sistemi. Vështirësi, po ashtu nuk ka, nëse ky proporcion është 3:1 kur dikush punon 40 vjet dhe jeton në pension për 15 vjet. Me kalimin e kohës kur sistemi është i vjetëruar, ky proporcion zakonisht dështon. Në Slloveni ky proporcion ka dështuar, derisa në Kosovë ende jo. Kur shumë njerëz të rinj janë të punësuar, ndërsa kemi vetëm disa pensionistë sistemi funksionon në mënyrë perfekte. Por kur popullsia fillon të vjetërsohet, kur numri i pensionerëve rritet më shpejt se numri i të punësuarve, atëherë duhet të reformohet sistemi. Në Slloveni është rasti kur numri i pensionistëve rritet më shpejt se punësimi i ri.

Numri i personave të siguar \times paga mesatare / numri i pensionistëve \times meatarja e pensionit = proporcioni duhet të jetë më i madh se 1.

Në 5 vitet e kaluara, kur nuk janë rritë kontributet në paga, është zbutur problemi i dështimit të proporcionit. Kështu 70 % e parave për pensione grumbullohet prej kontributeve të personave të siguar, ndërsa 30 % grumbullohen me subvencionim prej buxhetit. Ky system social po tregohet i efektshëm për shtetet e reja të formuara, në të cilat ka vetëm disa pensionistë dhe shumë të punësuar. Më vonë, ky sistem shndërrohet në strukturë piramidale; ai është i papërshtatshëm për pensionistët nëse deficioni nuk mbulohet nga shteti. Nëse ballafaqohemi me një plleshmëri minimale, siç është rasti në Slloveni, atëherë sistemi shumë lehtë mund të dështojë.

2. Për këto arsye Sllovenisë i është sugjeruar sistemi i kursimit, pra i investimeve. Niveli i pensioneve është i ndryshueshëm dhe ai varet nga niveli i kontributeve të të punësuarve. Ky është sistem kapitalist i kursimit në vend të

sistemit actual, i cili është sistem i modifikuar socialist. Sipas principit të sigurimit reziku është më pak i socializuar, ndërsa më shumë solidarizues.

Kompanitë e sigurimit e llogarisin mesataren e pensioneve të individëve duke e ndarë shumën e grumbulluar apo të kursyer me mesataren e pritur të periudhës jetësore.

3. Edhe nëse konsiderojmë se sistemi investues është më i mirë, ne kemi probleme, sepse nuk është lehtë të ndërrohet sistemi. Probleme shumë të mëdha do të kemi edhe atëherë kur dëshirojmë që këtë sistem ta fuqizojmë përmënjëherë. Ndonëse nuk kemi fond të pensioneve, ne ende duhet t'u paguajmë pensionet atyre të cilët i kanë fituar më parë. Nuk ka para të lira për kursime. Pagesat e njëhershme gjithashtu duhet t'i kursejmë. Prandaj në Slloveni ne e shohim si zgjidhje kompromisin me anë të cilit do t'i mbanim të dy sistemet në fazën e tranzicionit. Ne do ta kishim ende sistemin e vjetër dmth të ashtuquajturin »I.shtyllë«, dhe së bashku me të gjithashtu »II shtylla.«. Funkcioni i shtyllës I do të ishte të sigurojë një mbrojtje sociale minimale, shtylla II do të sigurojë bonuse. Pjesëmarrja në mes këtyre sistemeve do të varet nga mundësitë materiale. Pjesën më të madhe do ta përfaqësojnë kontributet, që i paguajnë individët (shtylla I), pjesa e dytë (shtylla e II) do të konsistojë prej kursimeve të individëve.

Pensionistët me të drejtë frikësohen se kursimet më vonë apo më herët do të ndikojnë në pensione më të vogla. Nëse pensionisti vdes para moshës jetësore të parashikuar, atëherë fitimet i mbesin kompanisë së sigurimeve; ndërsa nëse pensionisti jeton më gjatë, fitimet i mbesin personistit të siguruar. Kompanitë e sigurimeve duhet të jenë të vetëdijshme që nuk bën të llogarisin në moshë të shkurtër jetësore dhe rrjedhimisht në shumë të vogël të pensioneve.

Përkundër Kosovës, në Slloveni kemi një rënie demografike. Shtimi i popullsisë në shkallë vjetore për moshën në mes 45-55 vjeçe është 33.000 njerëz, ndërsa në moshën 5 vjeçare është vetëm 17.000 . Nëse nuk ka kursime, shumë pak njerëz duhet t'ua sigurojnë pensionet shumicës së mbetur.

4. Rolin e kompanive të sigurimit do ta marrin kompanitë e specializuara për sigurim pensional, të cilat do të organizohen si fonde reciproke ku investitorët janë të lirshëm të vendosin për kohën e tërheqjes së kursimeve. Por kur flasim për kompanitë e specializuara për sigurimin pensional nuk duhet neglizhuar roli i shtetit, sepse shteti është i obliguar të kujdeset për qytetarët dhe t'i detyrojë ata të kursejnë. Ata mund të tërheqin shumën e kursyer kur të përmbushin moshën minimale.

Ky sistem është më i përshtatshëm për vendet në zhvillim, për sistemet e vjetra, ku proporcioni në mes numrit të pensionistëve dhe dhe personave të siguruar nuk është relevant , ndonëse nuk është i parëndësishëm. Dobësitë e këtij sistemi në disa vende të BE janë zgjidhur duke stimuluar imigrimin e personave të siguruar. Ky sistem është i bazuar në produktivitetin e lartë nacional dhe jo në

numrin e të punësuarëve. Robotizimi i procesit të prodhimit në këtë rast ka efekte pozitive.

5. Si ta përmisojmë ose të zbusim këto mangësi?

Në rastin e Kosovës, për arsye demografike dhe për arsye të pensioneve të vogla nuk do të shfaqen së shpejti dobësitë e sistemit aktual, sikurse në Slloveni. Ne duhet sa më shpejt që mundemi të kalojmë në sistemin e kursimeve. Ekzistojnë disa ngrurrime lidhur me pensionet e privilegjuara, të cilat janë gati të shfuqizohen. Në këtë rast ne nuk do t'i ngarkojmë të gjitha pensionet në mënyrat lineare.

Në disa vende ekziston, gjithashtu edhe shtylla e tretë e cila përfaqëson sigurim shtesë (popullata është e lirë të vendos për këtë sigurim). Atë që në Slloveni e quajmë shtyllë të dytë, në vendet tjera quhet si shtyllë e tretë. Në të gjitha vendet e krahasuara ekziston problemi me kursimet. Nëse personat e siguruar heqin dorë nga kursimet, atëherë nuk do të ketë para për pagesat e pensioneve aktuale.

Si rregull, të gjitha vendet në tranzicion janë ballafaquar me një fazë të rëndë të shqetësimeve sociale (varfëria). Pensionet u zvogëluan shumë, ndërsa popullata këtë e konsideroi si një çmim të tranzicionit. Kjo do të thotë se u paraqit hapsira për kursime. Dhe këtu qëndron paradoksi: ndonëse nuk ka nevojë të shpejtohet në Kosovë për të implementuar sistemin e ri, ky sistem do të ishte më lehtë të implementohej, sepse ka hapsirë për kursime në interes të pensioneve të vogla. Ndonëse në Kosovë ka pasur reduktim me forcë të të drejtave pensionale në të kaluarën është pozitive sepse ata kanë hapësirë shumë të madhe për kursime, për aq sa ata ende do të shfrytëzonin pensionet në shkallën e vërtetë të vlerës aktuale. Natyrisht, kjo do të krijojë një efekt të madh në popullsi dhe duhet të pyesim vetveten nëse kjo është mirë apo jo, duke marrë parasysh që nuk ka nevojë për shpejtim të implementimit të këtij sistemi.

Maciej Grabowsky , Institute Gdansk

REFORMAT PENSIONALE NË POLONI

Sistemi i tanishëm i ka tri shtylla:

- Shtylla e parë: Sistemi i pagesës në vijim (Pay-as-you-go) i cili është i mbuluar tërësisht nga shteti, nëpërmes të institutit të quajtur ZUS (ose Fondi i Sigurimit Social). ZUS-i mbledh kontribute dhe paguan;
- Shtylla e dytë: Sistemi me detyrim. Kontributet dorëzohen në Fondin e Hapur Pensional (OPE) dhe janë të alokuara në tregun financiar për pensionet e ardhshme;
- Shtylla e tretë: Sistemi vullnetar. Kontributet mblidhen drejtpërdrejt nga Fondi Pensional duke iu referuar marrëveshjeve vullnetare të nënshkruara me punëtorë.

Normat dhe rregullat bazë:

	Punëdhënësi	Punëtori	Gjithsej
Kontributet për pensione	9,76%	9,76%	19,52%
Kontributet nga qiraja	6,50%	6,50%	13,00%
Kontributet për të sëmurët	-	2,45%	2,45%
Kontributet për aksidente	1,62%	-	1,62
Gjithsej	17,88	18,71	36,59%

Vërejtjet:

- Baza për këtë kontribut është paga para tatimit.
- Baza e kontributeve është e kufizuar deri 250% të pages mesatare. Kjo do të thotë se nëse personi fiton më shumë se 250% të pages mesatare, çdo shumë e cila është më e madhe se kjo nuk është bazë për kalkulimin e kontributeve.
- 7,3% e kontributeve pensionale paguhen nga puntorët dhe i janë dërguar OPE-së, nëse i punësuar është i lindur pas 01/01/1969, ose nëse ai është deklaruar dhe ka nënshkruar kontratën me OPE dhe është lindur pas 31/12/1948.
- Kontributet shëndetësore mblidhen ndaras (norma 7,5%).

Kjo reformë ka filluar nga viti 1999. Roli kryesor i saj ishte të zëvendësojë sistemin pay as you. Arsyeja kryesore për këtë ishte të menjanojë krizen e gjendjes së sistemit pensional ndërlidhur me zhvillimin demografik. Shoqëria polake po mplaket, prandaj kontributet e të punësuarëve prezentë do të jenë më të mëdha, ose pensionet do të reduktohen.

Paraprakisht, ka qenë vetëm sistemi PAYG në tërësi i financuar nga ZUS-i dhe nga grantet e shtetit. Pensioni është kalkuluar duke ju referuar formulave të komplikuar, duke marrë në shqyrtim kontributet, vitet e punës etj. Aktualisht pensioni mesatar është rreth 60% e pages mesatare.

- Shtylla e parë ende është e financuar nga ZUS-i. Ai siguron pensionet relativisht të vogla. Dhe roli i tij do të jetë gjithnjë më i vogël në të ardhmen.
- Shtylla e dytë është caktuar për punëtorë të ri. Kjo do të thotë se të punësuarit jo më të vjetër se 30 vjet (në 1999) obligimet e tyre i paguajnë për shtyllën e dytë (antarët e OPE). Ata që kanë qenë me moshë mesatare (mes 31 dhe 50 vjet) mund t' i bashkohen OPE-së, ose të qëndrojnë me sistem të vjetër. Sot rreth 10 milionë të punësuar (ose 2/3 e totalit) janë antarë të OPE-së.
- Shtylla e tretë është vullnetare.

Të dyja, OPE dhe Fondi Pensional janë të kontrolluara nga Këshilli special i kontrollit të shtetit. Ata licencojnë për këtë fond dhe kontrollojnë nëse i plotësojnë rregullat rreth investimeve (alokacionin e mjeteve). Një nga rregullat kryesore për ta është të plasojnë pjesën më të madhe të mjeteve në tregun financiar vendor; rregullat tjera kufizojnë ndarjen e investimeve përballë rregullave të shtetit. Roli tjetër i Agjensisë shtetërore të kontrollit është të sigurojë konkurrencë mes OPE-së dhe të sigurojë transparencë për konsumatorët potencialë.

Çdo kontribues (i punësuar) mund të ndërrojë OPE-n, nëse dëshiron ta bëjë atë. Objektiv kryesor i OPE-së është të menaxhojë kapitalin nga kontributet. Pensioni i parë nga shtylla e dytë do të jetë i paguar në vitin 2009. OPE-ja ka mbledhur tërësisht 15 miliardë zloty (ose 8 miliardë DM) në vitin 2000, gjë që është ekuivalent me 2% të GDP-së në Poloni. Pritet që në vitin 2006 totali i mjeteve të OPE-së të arrijë 100 miliardë zloty (ose 12-13% PKB), dhe në vitin 2011, 200 miliardë (ose 20% të PKB). Roli i këtyre mjeteve për investime në tregun e kapitalit do të rritet në mënyrë drastike. Aktualisht në 3 OPE kryesore janë të koncentruara 60% të mjeteve.

PËRVOJAT E REFORMAVE TË PENSIONEVE NË SHQIPËRI¹

Reformimi i pensioneve në Shqipëri lidhet me reformën e sigurimeve shoqërore. Objektivat e kësaj reforme ishin:

- Ndryshimi i lidhjeve të buxhetit të sigurimeve shoqërore me buxhetin e shtetit, për të qenë krejtësisht i pavarur dhe
- Krijimi i fondeve të sigurimeve shoqërore mbi bazën e kontributeve individuale të punëdhënësve dhe të punëmarrësve.

Në Shqipëri reforma e sigurimeve shoqërore e cila kishte për qëllim përshtatjen kushteve të reja të ekonomisë, filloi në vitin 1993. Me ligjin mbi sigurimet shoqërore, i cili ishte konceptuar mbi bazën e parimeve të fitimit, çdo punëdhënës dhe punëmarrës në sektorin publik e privat dhe në ndërmarrjet e përbashkëta duhet të paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore. Me këtë buxheti i sigurimeve shoqërore u shkëput nga buxheti i shtetit.

Skema e sigurimeve shoqërore në Shqipëri ka këto karakteristika:

- Veprimtaria e sigurimeve shoqërore mbulohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.
- Fushëveprimtaria e institutit lidhet me:
 - paaftësinë e përkohshme në punë
 - barrëlindjen,
 - pensionin e pleqërisë,
 - invaliditetin,
 - humbjen e mbajtësit të familjes
 - aksidentet në punë dhe
 - sëmundjet profesionale dhe papunësinë.
- Kontribute paguajnë:
 - individët e punësuar dhe punëdhënësit nga sektori privat, shtetëror dhe joint-venture.
 - Personat e punësuar në bizneset e vogla familjare, fermerët e tjera, si persona të punësuar dhe të vetëpunësuar.
- Skema shtetërore e pensioneve është e organizuar sipas parimit “pay as you go”, që do të thotë se pensionet për pensionistët vijues vijnë nga taksat vijuese dhe kontributet kombëtare të sigurimeve.
- Për të punësuarit, punëdhënësi derdhë 32.5% të fondit mujor të pagave (në kufij të pagës minimale); personat e punësuar paguajnë 10% të pagesës së tyre.

- Krahas sigurimit të detyrueshëm, ligji lejon hapësirë edhe për sigurimin vullnetar.

Për të krijuar kushte për sigurimin vullnetar pensional, në vitin 1995 në Shqipëri është aprovuar ligji për pensione suplementare dhe institutet private të pensioneve. Me këtë parashihet që skema e re e sigurimeve private të administrohet nga institutet private, fitimet e instituteve do të përdoren në dobi të personave të siguruar. Edhe përkundër ekzistimit të kushteve ligjore, në Shqipëri deri në vitin 1997 nuk ishte themeluar asnjë institut privat pensionesh.

PËRVOJAT E REFORMAVE TË PENSIONEVE NË KIL

Në vitin 1981 Kili zëvendësoi sistemin e vjetër “Pay-as-you-go “ të detyrueshëm (të administruar nga qeveria), me sistem individual të kapitalizuar, përsëri të detyrueshëm (por i administruar nga firmat private në konkurrencë AFP). Rezultatet e reformës në Kil kanë tërhequr vëmendjen e shumë vendeve në tranzicion dhe përvoja e Kilit na ndihmon të bëhet i mundur identifikimi i disa problemeve specifike me rastin e zbatimit të reformës .

Si mësim është se reforma e pensioneve duhet të jetë pjesë e një përpjekje të gjithanëshme për reforma ekonomike , pasi planet e pensioneve nuk veprojnë në një vakum institucional , por operacionet e tyre ndikojnë dhe janë të ndikuara nga veprimet e sektorëve tjerë të ekonomisë. Pra, si rezultat i reformimit të sistemit Kili bëri një seri ndryshimesh në *legjislacionin financiarë* (u dekretua një ligj i ri për Tregun e Letrave me Vlerë, bankat, kompanitë aksionere), *në tregun e kapitali* (sigurimi i një kuadri të aftë për të mrojtur investimet në fondet e pensioneve) , *në tregun e sigurimeve* (me ndryshimet që janë bërë ka arritur të krijojë informacione lidhur me eksperiencën e menaxhimit , investimet e kompanisë , rezervat , borxhet –për ata që kanë zgjedhur këtë formë të sigurimit).

Sistemi i AFP-së bazohet në disa principe:

- të drejtat pronësore individuale u vendosën në bazë të kontributeve në sigurimet shoqërore, dmth ekziston lidhja midis kontributeve dhe përfitimeve (*në sistemin e vjetër të pensioneve nuk ekzistonte e drejta pronësore mbi kontributet, fondet shpërndaheshin ndërmjet brezave dhe grupeve - ky ka qënë edhe problemi kryesor;*
- shtetit iu dha një pjesë dytësore në këtë sistem i cili duhet të sigurojë zbatimin eficient të një sistemi jo-diskriminues dhe uniform, të zgjidhë çdo lloj konflikti interesash që mund të ngrihet, të garantojë një minimum pensioni për ata që janë të paaftë ,etj ;

- sistemi manaxhohet nga firma private në konkurrencë –Administratorët e fondeve të pensioneve –me komision për hetimin e shërbimeve të tyre. Ky komision mbikëqyrës (Superindendency AFP) u vendos të sigurojë punonjësit ndaj riskut financiar dhe të kontrollojë investimet;
- Moshë ligjore e pensionit është 65 vjeç, për burrat dhe 60 vjeç, për grate. Në kushte të tjera specifike , dalja në pension mund të bëhet e mundur në një moshë më të re.

Një reformë do të jetë e suksesshme kur ekziston dëshira dhe përkrahja e punëtorëve, siç është rasti në Kil. Pas vendosjes së sistemit të ri të pensioneve , filloi transferimi masiv dhe i shpejtë i punëtorëve nga sistemi i vjetër .

SISTEMI PENSIONAL I LATVISË

Pas arritjes së pavarësisë në vitin 1990, Latvia ka formuar themelin e ekonomisë së tregut dhe zhvillimin e institucioneve demokratike . Reforma e parë e sistemit të mbrojtjes pensionale është ndërmarrë në vitin 1990. Fondi shtetërorë i sigurimeve shoqërore u nda nga buxheti i shtetit dhe administrohej nga këshilli trepalësh: përfaqësues nga organizatat e punëdhënësve, nga sindikatat e punëtorëve dhe nga qeveria.

Fondi i sigurimeve shoqërore financohet nga kontributi i punëdhënësve në shumë prej 30% të fondit të pagave dhe 1% nga kontributi i punëtorëve. Edhe pse këto norma nuk ishin të larta buxheti i shtetit ishte deficitar. Ky sistem i reformuar karakterizohet me kushte të mira pensionale (te femrat moshë e daljes në pension është 55 vjeçare , ndërsa te mashkujt 60 vjeçare, me mundësi të pensionimit të hershëm për profesione minorësh dhe kategori të tjera). Në janar të vitit 1995 mesatarja e moshës për dalje në pension ka qenë me 35 vjet përvojë pune, ose 50% e mesatarës së neto të ardhurave (pensionet nuk janë tatimuar). Në janar të vitit 1995 , qeveria ka paraqitë në parlament koncepte të reja për reforma të sistemit pensional , të ashtuquajtur sistemi tre rreshtorë .

- Radha e parë** do të modifikohet si sistem pay-as-you –go , me një lidhje të forte me kontributet , si dhe me një pension minimal që të mbrojë (sigurojë) të varfërit.
- Radha e dytë**, me karakter të obligueshëm , si sistem i financuar dhe i manaxhuar nga llogaritë e kursimit personal . Pjesëmarrja ishte e kufizuar për anëtar të rinj, si dhe për ata të rinj të cilët bëjnë pjesë në kontigjentin e punës.
- Radha e tretë**, vullnetare, pensionet e manaxhuara privatisht , parimisht të organizuara (por jo ekskluzivisht) nëpërmjet punëdhënësve.

Është parashikuar se lidhja midis pagimit të sigurimit dhe përfitimit të pensionit në të ardhmën do të qojë në zvogëlimin e punësimit të fshehtë dhe do të stimulojë aktivitetet ligjore. Sistemi i ri nuk ka ndonjë shtytje në moshën e daljes për pension . Minimumi i moshës për dalje në pension është mosha 60 vjeçare. Ky system i ri pensional siguron gjithashtu edhe një garancion minimal pensional për të gjithë ata që arrijnë moshën 60 vjeçare edhe nëse nuk kanë punuar . Ndihma sociale sigurohet edhe për personat të cilët e arrijnë moshën 60 vjeçare, por nuk kanë mbi 10 vjetë përvojë pune. Niveli nominal i ndihmës sociale vendoset nga qeveria . Momentalisht është 25 lats (60% e mesatares së pensioneve dhe 20% të mesatares së pagave) .

Megjithatë, disa pensione të caktuara vazhdojnë të jenë më të privileguara. Ato përfshihen në buxhetin e shtetit dhe jo në fondin e sigurimeve shoqërore. Këtu përfshihen pensionet e ushtarakëve , zyrtarëve shtetërorë të punëve të brendshme dhe të drejtësisë dhe pensionet e akademikëve. Pensione të veçanta ka edhe për personat me merita. Të gjitha këto pensione janë disa herë më të larta sesa pensioni i sigurimeve shoqërore.

Cilat janë dallimet e beneficioneve në mes të sistemit të vjetër dhe të sistemit të ri pensional ? . Në sistemin e vjetër shumica e pensionistëve me vite të plota të punës që dalin në pension, pas moshës 60 vjeçare nuk lejojnë ulje të beneficioneve . Për ata të cilët punojnë gjatë , beneficionet rriten 200% nëse vazhdojnë edhe 10 vite tjera . Beneficionet janë të larta sidomos për ata që i kanë të ardhurat e larta (të cilët në të ardhmën kontribuojnë më shumë), ndërsa beneficionet janë të ulta për ata të cilët i kanë të ardhurat e ulëta . Në sistemin e ri , dalja e hershme në pension dënohet, p.sh femrat të cilat dalin në pension në moshën 55 vjeçare do të kenë zbritje në pensionet e tyre , nëse i ndërprejnë kontributet . Sipas ligjit të ri , pas 10 viteve shpenzimet e pensioneve supozohet të jenë më të ulta për 1\3 e atyre që kanë mundur të jenë nën sistemin e vjetër . Si rezultat i kësaj , kontributet të cilat shpërndahen për pagimin e pensioneve janë zvogëluar nga 26% në 20% në vitin 2001. Për lituanezët nën moshën 40 vjeçare (që do të fillojnë të marrin pensione mbas 20 vjetëve), rreth 40% të pensioneve të tyre pritet të merren nga fondi i rradhës së dytë . Nga kjo pritet që në vitin 2005 rreth 10% të kontributeve të përgjithshme do të investohen për rritjen e kursimeve kombëtare.

REFORMA E SISTEMIT PENSIONAL NË HUNGARI

Skema e pensioneve në Hungari mund të shikohet nga aspekti i gjërë dhe i ngushtë. Skema e pensioneve në kuptimin e gjërë përfashin të gjitha llojet e pensioneve – si psh. asistencën, ndërsa skema e kufizuar i referohet vetëm pensionit të pleqërisë pas punës (kjo bëhet sipas të drejtës së tyre). Të dy skemat e pensioneve duhet të manaxhohen përmes një sistemi, pasi që shpeshherë

funksioni i pensioneve, i cili bazohet në vjetërsi, nuk korrespondon me moshën (për shembull, nganjëherë ndodhë që roli i pensionit invalidor dhe pensionit të hershëm apo para-pensionit nuk është i qartë).

1.1 Llojet e pensioneve në kuptimin e gjërë:

- Pensioni i pleqërisë;
- E drejta në pension ose e drejta e derjtpërdrejtë në pensionin e sigurimit social;
- Pensioni invalidor;
- Lejimet (ndihmat financiare) në rast aksidenti;
- Pensionet e minatorëve;

a.E drejta e tërthortë në pensione si janë:

- Pensioni i trashëguar (bartja e pensionit të vejani ose vejusha);
- Pensioni që trashëgohet nga prindërit;
- Lejimet (ndihma financiare) për personat që kanë mbetur jetimë;
- Pensionet që kanë të bëjnë me personat të cilët kanë mbijetuar nga aksidentet;
- Lejimet (ndihmat financiare) për anëtarët e kooperativave bujqësore;
- Para-pensionin ose pensionin i hershëm;

Reforma në sistemin e pensioneve të kuptimit të ngushtë (të kufizuar)

Sipas skemës së vjetër të pensioneve, të punësuarit i mbulojnë shërbimet e tanishme të cilat paguhen në favor të personave të pensionuar, ndërsa nuk bëhet ndonjë akumulim (kursim) i kapitalit. (Ky sistem është menaxhuar nga qeveria e zgjedhur, ndërsa më vonë edhe nga shteti).

Logjika e reformës sipas ligjit (aktit) LXXX (80) përfshinë:

- Detyrimet e e punëdhënësve dhe personave të siguruar;
- Rolin e shtetit si rregullator dhe garantues (nëse shpenzimet e sistemit të sigurimit social janë më të larta se sa të hyrat). Shteti duhet të ofrojë sigurimin e personave të moshuar dhe qytetarëve të paafte, përmes mjeteve të sistemit të sigurimit social, i cili është i obliguar dhe përmes sistemit përkatës të pensioneve private;
- Pjesëmarrjen e obligueshme të të siguruarve në sistemin social;
- Pagesën e obligueshme të kontributeve nga ana e punëdhënësve dhe personave të siguruar.

Skema është rregulluar sipas parimit të përgjegjësisë së përbashkët për personat e siguruar, punëdhënësve dhe shtetit. Si punëdhënësit, ashtu edhe punëmarrësit, duhet të paguajnë kontribute të cilat janë të specifikuar me ligj. Shteti do të jetë përgjegjës për funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të sigurimit social.

2.1 Sistemi i pensioneve sipas tri shtyllave: prarqitja e sistemit nga privatizimi i pjesërishëm dhe i kapitalizuar

Viti 1997 është viti i përshtatjes së ligjit mbi të ashtuquajturën skemën e re të pensioneve sipas tri shtyllave, i cili është më radikal, ndryshon nga sistemi i mëhershëm i bazuar vetëm në solidaritet, dhe funksionin sipas skemës *pay-as-you-go*. (pagesa në vijim, pagesa sipas së cilës beneficionet në të ardhmen varen nga kontributet e tanishme). Ndonëse skema e re ka filluar ta zëvendësojë atë të vjetrën që nga 1 Janari 1998, sistemi i vjetër ende është duke mbijetuar **për derisa ekzistojnë njërezit** të cilët nuk vendosin për të hyrë në sistemin e ri, dhe për shkak se Fondi i vjetër do të shërbejë si shtylla e parë në sistemin e ri. Sistemi i ri është i obligueshëm për të punësuarit të cilët fillojnë punën e tyre pas 30 qershorit 1998, dhe mund të jetë edhe për të tjerët.

Tri shtyllat e skemës së re janë si vijon:

- a. Fondi i sigurimit pensional
- b. Fondet e pensioneve private për sigurimin e obligueshëm privat
- c. Fondet e pensioneve vullnetare reciproke ose fondet e pensioneve private për sigurimin privat jo të obligueshëm (të cilat funksionojnë që nga fillimi i viteve të 90-ta)

Vendimi i të punësuarve për ta zgjedhur skemën e re është dashur të merret para fundit të gushtit 1999. Ata të cilët nuk kanë vendosur të bëhen anëtarë të ndonjë fondi privat të pensioneve në atë kohë do të mbeteshin në tërësi në sistemin *pay-as-you-go*.

Derisa shtylla e parë e skemës së re është Fondi i Sigurimit Pensional, shtylla e dytë e cila është e obligueshme – karakterizohet me sistemin e mbulesës në mjete, ku shërbimet për të ardhmen janë llogaritur në bazë të **mjeteve të akumuluarra në llogarinë personale të anëtarit**.

Në shtyllën e dytë, shërbimet në këste vjetore bëhen të drejta për t'u shfrytëzuar, më së shpejti **pas 15 viteve**. Anëtarit do të jetë në gjendje të zgjedh llojet e ndryshme të anuitetit dhe shumën e pagesës në para.

Shtylla e tretë përbëhet nga fondet vullnetare të pensioneve, të cilat janë rregulluar sipas ligjit të vitit 1993. Kjo lejon mundësinë e përjashtimit nga tatimi të pjesëmarrësve.

2.2 Mbulesa në mjete dhe kontributi

Për shumën e kontributeve dhe beneficioneve vendos pushteti legjislativ, dhe kjo është rregulluar sipas aktit LXXX të vitit 1997. Mbulesa në mjete e pensioneve të sigurimit social realizohet nga **kontributet** e punëdhënësve dhe punëmarrësve. Shteti duhet të sigurojë se beneficionet e pensioneve janë paguar edhe në rastin kur shpensimet e fondit për sigurim pensional social tejkalojnë të hyrat. Nëse shpensimet e parashikuara (anticipuara) të fondit për sigurim

pensional tejkalojnë të hyrat, atëherë diferenca duhet të mbulohet nga buxheti qendror. (Akti LXXX i vitit 1997, no 2 (2)).

Në vitin 1999 dhe 2000, të punësuarit të cilët kanë mbetur me sistemin e vjetër ndajnë 8% nga pagat e tyre mujore për fondin e sigurimit pensional, sipas shtyllës së parë. Nëse ndonjëri prej tyre ka zgjedhur skemën e re të pensioneve, atëherë 2% e pagës duhet të paguhet në llogari të fondit për sigurim pensional dhe 6% fondit privat për pension. (Faktikisht në vitin 2000 kontributi për shtyllën e dytë do të ishte 8%).

Punëdhënësi duhet të paguajë për shpenzimet e punës 22% nga paga në llogari të fondit për sigurim pensional. (Më 1997 kontributi i punëdhënësit ishte 24%, ndërsa i punëmarrësit 7%, nga të cilat 6% është dashur t'i paguhet fondit privat për pensione).

2.3 Themelimi dhe udhëheqja e fondeve private të pensioneve

Me Ligjin mbi pensionet private dhe fondet private të pensioneve (akti LXXX i vitit 1997):

- është përmirësuar (adaptuar) nga parlamenti me qëllim të themelimit dhe funksionimit të sistemit privat të pensioneve;
- anëtarët e fondit privat të pensioneve do të deponojnë rezerva së bashku të cilat kërkohen për funksionimin e fondit dhe sigurimin e beneficioneve që dalin nga pensionet. Gjatë periudhës së deponimit (akumulimit), anëtarët do të formojnë një komunitet për rrezikun e investimit, dhe një komunitet për rrezikun e sigurimit gjatë periudhës kur fillojnë t'i gëzojnë beneficionet.
- Fondet do të sigurojnë performancën (veprimatrinë, funksionimin) e obliguesve nga tyre përmes themelimit dhe mirëmbajtjes së fondit garantues. PAGESA normative e pensionit është minimumi i pagesës së pensioneve që duhet t'i paguhet ndonjë anëtarit të fondit, pagesa ndaj të cilit duhet të jetë e garantuar nga Fondi Garantues i Pensioneve të fondeve, në kohën kur llogaritet pensioni.

Fondet private të pensioneve mund të themelohen nga:

- punëdhënësit në veçanti ose bashkërisht, filialat (odat) në veçanti ose bashkërisht, shoqatat profesionale në veçanti ose bashkërisht, ose së bashku me një (apo me shumë) oda, pastaj, nga orgaznizatata që përfaqësojnë interesa të punëmarrësve dhe/ose të punëdhënësve në veçanti ose bashkërisht, ose së bashku me entitete e lartpërmendura; dhe nga
- Administrata e sigurimit pensional, nëse palët parashikojnë se numri i anëtarëve të fondit do të arrijë në 2000 persona.

REFORMA PENSIONALE NË KROACI

Kroacia ka filluar procesin e reformës së sistemit pensional nga villimi i vitit 1999. Reformimi i sistemit pensional është koncipuar në tre nivele:

1. Sigurimi i detyrueshëm pensional, në bazë të solidarizimit të gjeneratës (shtylla e parë e pensionit);
2. sigurimi i detyrueshëm pensional në bazë të pleqërisë, bazuar në kursimet e kapitalizuara individuale (shtylla e dytë e pensioneve); dhe
3. sigurimi vullnetar pensional në bazë të kursimeve individuale të kapitalizuara (shtylla e tretë e pensioneve).

Në aspektin ligjor, shtylla e parë e pensioneve është rregulluar me Ligjin mbi sigurimin pensional, shtylla e dytë dhe e tretë rregullohet me Ligjin mbi fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare.

Shtylla e dytë dhe e tretë e pensioneve është dashur të fillojnë së aplikuari nga data 1 shtator e vitit 2000, por aplikimi i tillë është prolonguar për fillimin e vitit 2002.

Ndër problemet themelore të reformës pensionale në Kroaci, theksohen shpenzimet e tranzicionit të cilat janë të lidhura me mbulimin e shpenzimeve, të cilat janë rrjedhojë e aplikimit të shtyllës së dytë të pensioneve.

Shkalla e përgjithshme e kontributeve për sigurime pensionale (në paga) deri më tani ishte 19,5%. Nga kjo normë financohej shtylla e parë (pensionimi në bazë të moshës). Kjo shkallë planifikohet të zvogëlohet me aplikimin e shtyllës së dytë (të kursimeve pensionale individuale të kapitalizuara). Parashihet që shkalla e kontributeve për financimin e shtyllës së dytë nuk mund të jetë më e ulët se 5% nga shkalla e pagimit të kontributeve për shtyllën e parë. Në shtyllën e dytë janë të obliguar me ligj të paguajnë kontribute të gjitha ata të cilët janë më të ri se 40 vjeç si dhe ata të cilën parcaktohen vetë, kurse gjenden në mes moshës 40 dhe 50 vjeçare.

Entit Kroat për Sigurimin Social edhe në kushtet e deritanishme, kur shkalla e kontributeve ishte 19,5%, i mungonin fondet për pagimin e rregullt të pensioneve. Problemet në këtë vend janë edhe më të mëdha, nga fakti se buxheti shtetëror është më i ulët nga ai i viteve të mëparme, ndërsa nga ai duhet të sigurohen mjetet për mbulimin e shpenzimeve tranzitore.

Nga çështjet të cilat konsiderohen se duhet të ridefinohen janë ato që kanë të bëjnë me definimin e invaliditetit , përkufizimi i kurifit kohor për pensionim, baza për përlllogaritjen e pensionit dhe të vetë institucioneve të cilat merren me pensione.